



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”

ofruar nga

Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Merita Xhumari

Prof.Asoc.Dr.Elda Zotaj

Dhjetor/ 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master Profesional në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politika
Sociale", "Administratë Publike", "Qeverisje Vendore"

1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”				
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare				
3	Emërtimi i programit të studimit:	“Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile "Politika Sociale", "Administratë Publike", "Qeverisje Vendore”				
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 482, datë 03.10.2011				
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-				
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 378, datë 23.10.2020 (profili Administratë Publike); UMASR Nr. 379, datë 23.10.2020 (profili Qeverisje Vendore); UMASR Nr. 380, datë 23.10.2020 (profili Politika Sociale)				
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër MASH Nr. 291, datë 11.07.2012; VBA Nr. 62 datë 28.09.2018				
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë				
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit/ 2 semestra				
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS				
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë				
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip				
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-				
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-				
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-				
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7				
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Tituj/grada	2022 -2023		2023 - 2024	
			PAE	PAK	PAE	PAK
		Prof.Dr	-	-	-	-
		Prof.As.Dr	1	-	1	-
		Dr/PhD	4	-	4	-
		Msc	-	-	-	-
	Në total	5	0	5	0	

18	Numri i studentëve:	20-21: 38 studentë 21-22: 28 studentë 22-23: 23 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, ofrohet nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Njësia kryesore ku bën pjesë ky program studimi është Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe njësia bazë që e ofron këtë program është Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi është licensuar me Urdhër Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 482, datë 03.10.2011 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 62 datë 28.09.2018.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamenti i Psikologjisë. Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të parë, të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve në arsimin e lartë.

Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, 60 ECTS dhe kohëzgjatje 1 vit akademike / 2 semestra. Programi i studimit i përket nivelit 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standardet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Nga takimi me stafet drejtuese dhe akademike të programit të studimit, GVJ konstatoi se ka një vëmendje të vazhdueshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjes në karrierën akademike e profesionale të stafit akademik, duke marrë pjesë në aktivitete kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Studentët e këtij programi studimi vlerësuan se ata mbështen nga stafi akademik,



duke u përfshirë në konferencat studentore me tematika relevante për programin e studimit, e të tjera aktivitete të UMSH.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që UMSH ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces në insititutucion të zhvilluar në datat 5 dhe 6 Shkurt 2024 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më reale situatën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof.Dr. Merita Xhumari dhe Prof.Asoc.Dr. Elda Zotaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Rajna Lila, koordinatore teknike e ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të Vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Master Profesional në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politika Sociale", "Administratë Publike", "Qeverisje Vendore", si edhe ofron rekomandime të cilat mund të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të profesionistëve të rinj në shkencat politike.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.62, datë 28.09.2018 janë:

- a) Institucioni të rishikoj në planin mësimor të këtij programi studimi, me qëllim diferencimin sa më të qartë të profileve “Politikë Sociale” dhe “Qeverisje Vendore”, duke parashikuar dhe përfshirjen e lëndëve me zgjedhje si pjesë e aktiviteteve formuese të grupit E
- b) Institucioni të hartojë një rregullore funksionimi të të Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës dhe të garantoj zbatimin e saj në vijim.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

UMSH përmes Planit të Veprimit për të përmbushur rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit për programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” ka përvijuar hapat që duhet të ndiqen nga strukturat brenda institucionit për realizimin e tyre. Në lidhje me rekomandimet e pikës a, UMSH dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në vitin akademik 2018-2019 ka bërë rishikimin në planin mësimor të këtij programi studimi duke bërë diferencimin në planet mësimore ku nga 9 lëndë, 6 janë të përbashkëta dhe 3 të ndryshme sipas profileve respektive. Kurrikula ka lëndë të kategorisë E por nuk ofron lëndë me zgjedhje. UMSH ka përmbushur pjesërisht rekomandimin në pikën a.

Në lidhje me rekomandimet e pikës b, institucioni menjëherë pas akreditimit në vitin 2018-2019 hartoi rregulloren e funksionimi të Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Vizita në institucion konfirmon dokumentin (*Evidenca Nr.38. Rregullore e ZKSK*) dhe angazhimin e strukturave të UMSH për zbatimin e saj në vijim. UMSH ka përmbushur plotësisht rekomandimin në pikën b.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë i cili ofron programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, ofron programe studimi në raport me interesat kombëtare si dhe ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Më konkretisht, në Statutin e Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë, neni 4 “Vizioni dhe Misioni i UMSH” është përcaktuar se “Vizioni i UMSH është krijimi i një institucioni të arsimit të lartë cilësor, i cili ofron vlera të vërteta qytetarie dhe profesionalizmi; nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor të përgatis qytetar të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv dhe në përputhje me interesat kombëtare.” Gjithashtu në misionin e këtij institucioni në pikën “e” theksohet se UMSH: “të kontribuojë në mbështetje të prioritetëve strategjike dhe të interesave të zhvillimit të vendit”. (Evidenca Nr. 1. Statuti UMSH fq.3-4) Ky program studimi është përgatitur për të pajisur studentët me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme që do t’i mundësojnë ata të jenë konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe të formojnë baza për t’u integruar në tregun e punës apo për të vijuar avancime të mëtejshme akademike.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, është në përputhje me misionin e fushën e veprimtarisë së UMSH dhe planin strategjik të zhvillimit të tij. Në Planin Strategjik të Zhvillimit të UMSH theksohet misioni i institucionit “për t’i dhënë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm; t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të

	mira, dijes, shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare”. (Evidenca Nr. 4. <i>Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH fq.6</i>) Në dokumentin e titulluar “Strategjia e Zhvillimit te Programit” thuhet se: “Misioni i këtij programi është t’i pajisë studentët me njohuri themelore për formimin e tyre si specialistë të shkencave politike, administratës publike, si dhe për vazhdimin e studimeve në fushën e shkencave politike dhe të fushave të përafërta. (Evidenca Nr. 5. <i>Strategjia e Zhvillimit te Programit fq.3</i>). Institucioni ofron programe studimi të afërta me këtë program studimi.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	Bazuar në dokumentat themelore të UMSH, vizita në institucion dhe takimet me stafin dhe drejtuesit e tij, rezulton se programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” është hartuar në përputhje dhe në zbatim të Statutit, Rregullores së Organizimit, të Planit Strategjisë për zhvillimin e institucionit dhe programit të studimit të UMSH. (Evidenca Nr. 1. <i>Statuti</i>; Evidenca Nr. 2. <i>Rregullore e Organizimit UMSH</i>; Evidenca Nr. 4. <i>Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH</i>; Evidenca Nr. 5. <i>Strategjia e Zhvillimit të Programit</i>). Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane (Evidenca Nr. 8. <i>Rregullore e DSHPMN</i>). Emërtimi, struktura dhe organizimi i programit të studimit bazohet dhe është ndërtuar mbi fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim zhvillimit të UMSH. Në hartimin e programit të ciklit të dytë të studimit MP në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, synohet të formohen studentët me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale nëpërmjet mësimdhënies, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të teorisë, praktikës dhe shkencës në lëmin e Shkencave Politike dhe profilizimeve respektive.
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës	Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” është hartuar e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit me qasje të bazuar në përputhje me interesin kombëtar, si dhe prirjet globale të zhvillimit politik dhe ekonomik. Kurrikula e këtij programi studimi është hartuar duke u bazuar në dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe i shërben formimit të profesionistëve në të gjitha nivelet (Evidenca Nr. 14. <i>Plani Mesimor i programit të</i>

vendas dhe atë ndërkombëtar.	studimit). Programi synon të furnizojë tregun me specialistë njohës të politikës, administrimit dhe zhvillimeve ndërkombëtare, duke i shërbyer rritjes së performancës së institucioneve të shtetit dhe organizmave ndërkombëtare që zhvillojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë, si dhe zhvillimit ekonomik dhe social në tërësi. (Evidenca Nr. 4. Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH)			
Konkluzione	Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë" i cili ofron programin e studimit Master Profesional në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politika Sociale", "Administratë Publike", "Qeverisje Vendore", përmbush plotësisht kriteret e vlerësimit dhe synon ruajtjen e interesave kombëtare, akteve ligjore dhe nënligjore, etj. Në dokumentet ligjore institucionale janë të shprehura qartë misioni dhe vizioni i institucionit për programe studimi bashkëkohore, kontributive dhe zhvillimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane ku përfshihet edhe programi i studimit është një nga tre njësitë kryesore të UMSH. Ky fakultet përbëhet nga 4 njësi bazë si: 1. Departamenti i së Drejtës; 2. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; 3. Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë; 4. Departamenti i Edukimit, Komunikimit dhe Formimit të Kompetencave. Programi i studimit Master Profesional në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politika Sociale", "Administratë Publike", "Qeverisje Vendore" ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. (Evidenca Nr. 2. Rregullore e Organizimit UMSH). Programi është licensuar me Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 482, datë 03.10.2011 dhe që nga hapja e tij ka kaluar me sukses dy procese akreditimi. Struktura institucionale e UMSH-së është në funksion të misionit dhe e organizuar në përputhje me fushën akademike



	specifike për ofrimin e programit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” dhe disponon burimet e nevojshme njerëzore, të cilët janë të përfshira në realizimin e objektivave të këtij programi. Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni rezulton se për vitin akademik 2022-2023, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në përbërje të tij ka 11 anëtarë të stafit akademik efektiv me kohë të plotë. Stafi akademik i departamentit me kohë të plotë është i pajisur me tituj dhe grada si vijon: 1 Prof. Dr, 2 Prof. Asoc, 6 anëtar me gradën Dr, 1 Dr në proces dhe 1 me Msc. (<i>Evidenca Nr.16. Permblledhëse e tabelave për programin e studimit, fq.1</i>). Departamenti është i përbërë nga anëtarë me përvojë të gjatë akademike dhe profesionale (<i>Evidenca Nr.14.3. CV e stafit akademik</i>). Gjithashtu gjatë vitit akademik 2022-2023 janë angazhuar dhe 5 anëtarë të stafit akademik me kohë të pjesshme përkatësisht 4 Dr dhe 1 Dr në proces.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se programi MP në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” gjendet në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane si njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit, i takon fushës së studimit të Shkencave Humane (nr.2) dhe Biznesit e Drejtësisë (nr.4), ndryshe nga programi që i takon Shkencave Sociale (nr.3) sipas klasifikimit ISCED 2011. Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” është në nivelin 7 në kornizën kombëtare të kualifikimeve. Fusha e përgjithshme e programit të studimit nuk është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për zbatimin e këtij programi studimi.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë	Masteri Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” ofrohet bazuar në Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe akteve rregullatore të UMSH. Programi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë ku ofrohet, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Bazuar në udhëzimet kombëtare dhe evropiane, ky program ka 60 ECTS, përgjatë një viti akademik dhe është i shtrirë në dy semestra. (<i>Evidenca Nr. 14. Plani Mesimor i programit të studimit</i>). Nga shqyrtimi që GVJ u ka bërë syllabuseve të programit,

bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	rezulton përputhshmërin e tij me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. (Evidenca Nr. 14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023) Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të Masterit Profesional përputhet me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik të Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Njësia bazë është e konsoliduar në burimet njerëzore dhe ka kompetencat e nevojshme për të ofruar një program të tillë. <i>Si një program ndërdisiplinor ku ndërthuren shkencat politike edhe ato ekonomike, të dyja këto disiplina i takojnë kategorisë së Shkencave Sociale (nr.3) sipas klasifikimit ISCED 2011.</i> <i>Ky klasifikim është sanksionuar edhe nga qeveria shqiptare me VKM nr.288, date 11.05.2022 dhe VKM nr.310, date 11.05.2022.</i> (Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN; Evidenca Nr.16. Përmbledhëse e Tabelave për programin)
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Për periudhën e akreditimit ky kriter nuk është i aplikueshëm. Në RVB thuhet se kohët e fundit institucioni ka krijuar Zyrën e Kurseve Profesionale Afatshkurtër. (RVB, fq.9)
Konkluzione	<i>GVJ bazuar në gjetjet e evidentuara më sipër, konfirmon se Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, është e konsoliduar në burimet njerëzore dhe ka kompetencat për të ofruar një program të tillë Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, i cili i përket kategorisë së Shkencave Sociale (nr.3) sipas klasifikimit ISCED 2011.</i> <i>Referuar mospërputhjes së fushës së programit të studimit në Shkenca Sociale (Kategoria nr.3) me njësinë kryesore, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane (miksimit i Kategorive nr. 2 + nr.4) sipas standardeve ndërkombëtare ISCED 2011, kërkohet</i>



	reflektimin nga institucioni që të përmbushë si standardet ndërkombëtare ISCED, edhe legjislacionin shqiptar si VKM nr.288, datë 11.05.2022 dhe VKM nr.310, datë 11.05.2022.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimi profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në dokumentet themelore të UMSH si Statuti dhe Rregullorja e Organizimit, janë të përcaktuara qartë strukturat institucionale me karakter akademik dhe administrativ për realizimin e aktiviteteve në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit. Në Rregulloren e Organizimit thuhet se: “UMSH përbëhet nga njësitë organizative: kryesore, bazë, ndihmëse dhe njësi administrative”. (Evidenca Nr.2. Rregullore e Organizimit UMSH fq.5) Organizimi i institucionit harmonizon strukturat akademike me ato vendim-marrëse dhe administrative. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësive akademike dhe administrative të institucionit, por pesha kryesore mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit (Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN). Departamenti ka hartuar dhe një Rregullore për këtë program studimi. (Evidenca Nr. 9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile) Institucioni garanton që programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” të realizohet nga staf i kualifikuar si në drejtimin akademik dhe në atë administrativ apo institucional. Departamenti merr masat që personeli akademik me kohë të plotë (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) të realizojnë orët mësimore sipas planit mësimor akademik, personeli ndihmës administrativ të jetë në shërbim të vazhdueshëm duke krijuar kushte shumë të mira me qëllim realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. Gjithashtu njësi të tjera si: sekretaria, arkiva, shërbimi i informacionit në zyrat e ndryshme, janë në shërbim me kohë të plotë në mënyrë funksionale në realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Çdo strukturë/njësi përgjegjëse ndjek dhe monitoron në mënyrë të

Masa

[Signature]

	vazhdueshme ecurinë e programit të studimit dhe informon drejtuesit përkatës.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit dhe organizata të shoqërisë civile. <i>(Evidenca Nr.10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH)</i> . Gjithashtu UMSH në vitin 2017 ka hartuar Strategjinë e Ndërkombëtarizimit në nivel institucional për të zhvilluar edhe më shumë njohjen dhe kooperimin me partnerët brenda dhe jashtë vendit. <i>(Evidenca Nr.23. Strategjia e Nderkombetarizimit)</i> . Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përfiton nga marrëveshjet e bashkëpunimit të realizuara në nivel fakulteti, ashtu edhe në kuadër të marrëveshjeve të realizuara në nivel institucional. Në fushën e shkencave politike, institucioni ka lidhur marrëveshje me 16 universitete jashtë vendit. <i>(Evidenca tek dokumentet shtesë: Raport Bashkëpunimi me Universitete)</i> . Përfitimet nga këto marrëveshje janë në radhë të parë përmes bashkëpunimit institucional dhe shkëmbimit të eksperiencave mes palëve. Ato krijojnë mundësi që studentët të zhvillojnë praktikat profesionale pranë këtyre institucioneve, si dhe japin mundësinë e shkëmbimit të stafeve akademike për shkëmbim eksperiencash me universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni përmes dokumenteve të tilla si: Statuti, Rregullorja e Organizimit UMSH, Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH dhe Strategjia e Ndërkombëtarizimit përcaktojnë synimet kryesore dhe objektivat që i korrespondojnë edhe ndërveprimit me institucione, kompani të fushave përkatëse dhe instituteve kërkimore për realizimin e praktikave profesionale apo stazhit. Praktika profesionale ka 6 kredite të përkthyer në 150 orë pune të shtrira në semestrin e dytë. Për ciklin e studimit master, praktika zhvillohet tek institucionet e përcaktuara nga njësia bazë e UMSH. Në bazë të dokumentit “Udhëzues për praktikat”, studenti duhet të punojë jo më pak se 20 orë në javë përgjatë periudhës së përcaktuar. Gjatë kësaj kohe studenti mbikëqyret nga një person i caktuar në institucion. <i>(Evidenca 13. Udhëzues për praktikat dhe Formularët)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse	Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni nuk rezulton që njësia bazë të realizojë në mënyrë periodike raporte

për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Në dokumentacionin shtesë është përcjell dokumenti me emërtimin “Raport Bashkëpunimi me Universitete” i cili është një faqe dhe përmend universitetet ku ka bashkëpunim UMSH në fushën e shkencave politike. <i>Ajo që propozohet nga GVJ është që në të ardhmen njësi bazë të realizojë në mënyrë periodike raporte analitike nga përfitueshmëria e marrëveshjeve në kuadër të realizimit të këtij programi studimi.</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimin në institucion, GVJ konkludon se njësitë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e programit sigurojnë marrëdhënie dhe kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë dhe kombëtarë për realizimin sa më efektiv të këtij programi. GVJ sygjeron që njësi bazë të realizojë raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës i	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë	Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” është i organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) në total me 60 ECTS. Programi është i përbërë nga 7 kurse të

përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	organizuara në 4 lëndë të quajtura “Trungu i përbashkët” që ofrohen për të gjithë studentët në vitin e parë dhe 3 lëndë të profilizuara për specifikat e çdo profili, plus praktikën dhe provim formimi/diploma. Programi i studimit reflekton qartë elementët e duhur të strukturës së një programi të studimi MP. (<i>Evidenca Nr.14. Plani Mësimor i programit të studimit</i>). Programi është në përputhje me kriteret e përcaktuar në VKM Nr. 41/2018 (i ndryshuar). Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Kategoria A: Lëndë bazë- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (6 ECTS; 10%) Kategoria B: Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (24 ECTS; 41%) Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese – grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje. (14 ECTS; 24%) Kategoria D: Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale. (6 ECTS; 10%) Kategoria E: Detyrime përmbyllëse – punimi i diplomës (9 ECTS; 15%) (<i>Evidenca Nr.14. Plani Mësimor i programit të studimit</i>)
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit, Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” synon t’i pajisë studentët me njohuri themelore për formimin e tyre si specialistë të shkencave politike, administratës publike, si dhe për vazhdimin e studimeve në fushën e shkencave politike dhe të fushave të përafërta. (<i>Evidenca Nr.5. Strategjia e Zhvillimit të Programit, fq.2</i>). Programi i studimit synon që nëpërmjet trupës së lëndëve si dhe profilizimet e ofruara, t’u japë studentëve njohuri sa më koherente gjithëpërfshirëse dhe terminologjinë e duhur që ju duhet në formimin e tyre profesional. Në syllabuset e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite rezultatet e të nxëniet dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të çdo lënde (<i>Evidenca Nr. 14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023</i>). Aftësitë shprehimore e teknike i lejojnë studentët për t’u përballur me specializime profesionale në punë të kualifikuara ku nevojiten njohuritë që lidhen me këtë program studimi.

Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Konkretisht, praktika mësimore realizohet në semestrin e dytë dhe ka 6 kredite, ndërsa punimi i diplomës ka 9 kredite. (Evidenca Nr.14. Plani Mesimor i programit të studimit)
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.

të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.				
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Institucioni ka realizuar procesin e kodifikimit të programeve dhe ka njoftuar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Bazuar në RVB, për programin e ciklit të dytë, Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, ka të përcaktuar kodin 0312. (RVB fq.15)			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.			
Konkluzione	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ evidenton se programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore të institucionit. Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” është i organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) në total me 60 ECTS. Programi i studimit synon që nëpërmjet trupës së lëndëve si dhe profilizimet e ofruara, t’u japë studentëve njohuri sa më koherente gjithëpërfshirëse. Institucioni ka realizuar procesin e kodifikimit të programit të studimit i cili ka kodin 0312.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Veprimtaria e Fakultetit dhe Departamentit bazohet në aktet rregullatore të Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e parashikuara në këto akte. Për organizimin e punës, krahas akteve në nivel institucional si Rregullore Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti, departamenti ka miratuar dhe një Rregullore të dedikuar për programin e studimit Master Shkencor në “Shkenca Politike” (*Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit MSH Shkenca Politike*). Në këtë dokument janë të përcaktuara detajet dhe specifikimet e programit, qëllimet dhe objektivat e tij, mënyra e organizimit të studimeve, plani mësimor etj. Ky departament përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin, strukturën dhe stafet akademike.

Përbërja e Departamentit paraqitet si në vijim:

Tituj/ grada	2020 – 2021		2021 – 2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	1	-
Prof. Asoc.	1	-	2	-	2	-
Dr./PhD.	6	1	5	1	6	4
Msc.	2	1	2	2	2	1
Totali	9	2	9	3	11	5

(Evidenca 16. Përmbledhje e Tabelave për programin e studimit Tabela 1-Tabela 2)

Masa



	<i>(Evidenca Nr. 38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP; Tabelat përmbledhëse, tabelat 2).</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, sikurse edhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare kanë numrin e nevojshëm të personelit akademik dhe ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore dhe kapacitetet për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i këtij programi studimor. <i>(Evidenca Nr. 16. Përmbledhese e tabelave për programin e studimit; Evidenca Nr. 7. Rregullore e FDSHH)</i> Angazhimi i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është përgjithësisht i përshtatshëm në drejtim të arritjes së objektivave të programit të studimit. Sipas programit mësimor “Praktika profesionale” realizohet në semestrin e II të vitit akademik dhe ka 6 kredite. <i>(Evidenca Nr. 14. Plani Mësimor i programit të studimit)</i> <i>GVJ konfirmon se institucioni ka bashkëpunim të ngushtë me institucionet ku zhvillohen praktikat mësimore. GVJ nga bisedat me studentët konfirmoi se Departamenti i drejtonte ata në praktika profesionale, si në institucionet publike, ashtu dhe OSHC që operojnë në këtë fushë.</i> <i>(Evidenca Nr. 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH)</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në aktet rregullatore të UMSH-së është përcaktuar pozicioni i Koordinatorit për programet master. Pozicioni i koordinatorit realizon bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet departamenteve për programin e studimit master, monitorimin, si dhe është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale, duke koordinuar veprimtarinë ndërmjet njësisë bazë dhe institucioneve publike e jopublike me të cilat institucioni ka marrëveshje. <i>(Evidenca Nr. 7. Rregullore e FDSHH).</i>
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Stafet akademike dhe ndihmës akademike janë të përshtatshëm në drejtim të arritjes së objektivave të programit të studimit. Pozicioni i koordinatorit realizon bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet departamenteve për programin e studimit master, monitorimin, si dhe është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale.</i>

Maso



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare kanë strukturën dhe kapacitetet akademike dhe administrative, dokumentacionin dhe teknikalitetet e nevojshme lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Informacioni dhe teknikalitetet janë të aksesueshme dhe ju vihen në dispozicion stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve që ndjekin këtë program studimi. Përgjegjësi i Departamentit mban komunikim dhe informon Dekanin e Fakultetit me zhvillimet që lidhen me punët e departamentit, studentët, anëtarët e stafit akademik dhe ndihmës akademik/administrative etj. (Evidenca Nr.7. Rregullore e FDSHH; Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN). <i>GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe punim diplome të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), të cilat zhvillohen në një vit akademik, të ndarë në dy semestra.</i> <i>(Evidenca Nr. 14. Plani Mesimor i programit të studimit).</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të	Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen në lëndë, praktikë dhe punimi i diplomës të shprehura në kredite ECTS. Programi i studimit ka një ngarkesë prej 60 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 1 viti, në dy semestra. Plani mësimor ka ngarkesën mësimore me orët në auditor dhe jashtë tij. Praktika si lëndë

Maso



lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plotësuese (D) përbën 6 ECTS dhe Detyrime Përmblyëse (E) përbën 9 ECTS. (Evidenca Nr.14. Plani Mësimor i programit të studimit). Në program, lëndët e profilizuara janë në harmoni dhe në mbështetje të profileve që ka ky program duke përmbyshur dhe rekomandimet e akreditimit të mëparshëm. Gjuha e programit të studimit është Shqip. Në Rregulloren e institucionit, Rregulloren e programit të studimit si dhe në çdo syllabus përcaktohen rregullat për frekuentimin e mësimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj. <i>(Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile; Evidenca Nr.14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023).</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Institucioni ka të përcaktuara qartë kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve në programin e studimit Master Profesional të cilin mund ta ndjekin studentë nga universitetet shqiptare (publike e private) si dhe nga trevat shqip-folëse. Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore të institucionit, përfshirë rregulloren e programit të studimit dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit (Kreu II; nga Neni 12 deri tek Neni 15; Rregullorja e Programit të studimit). Procedurat e pranimit të studentëve të rinj realizohen nga një komision i veçantë pedagogësh duke marrë parasysh vit pas viti kriteret bazë të vendosura nga Ministria përgjegjëse për arsimin. Programi është i organizuar në mënyrë që të lejojë transferim të studimeve nga/në programe të tjera, duke bërë ekuivalentimin e njohurive të shprehura në ECTS. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të UMSH. <i>(Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile; Evidenca Nr.16. Broshura e programeve Master).</i> https://www.umsh.edu.al/c/143/pranimet https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe	Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” organizohet në lëndë, praktikë dhe punimi i diplomës të shprehura në kredite ECTS dhe të grupuara sipas komponentëve mësimorë formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit janë hartuar në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe janë të strukturuar sipas formatit të miratuar në nivel institucioni. Në to paraqitet informacion i detajuar në lidhje me

jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të studjojë. (Evidenca Nr.14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023).			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm nga DSHPMN. Nga biseda e GVJ me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit doli e qartë se çdo vit akademik, DPSHPMN bën analizë të syllabuseve të të gjitha lëndëve të programit, sipas procedurave përkatëse dhe në kohë të mjaftueshme përpara fillimit të procesit mësimor. Syllabusi paraqitet nga titullari i lëndës, i cili ka të paktën gradën “Doktor i Shkencave”. Rishikimi dhe përditësimi i lëndëve të ofruara në këtë program studimi realizohet nga lektorët përgjegjës të departamentit, dhe çdo silabus përditësohet dhe miratohet përpara fillimit të vitit akademik nga departamenti. Analiza e syllabusit merr parasysh të gjithë elementët e tij thelbësorë duke u ndalur në përputhjen e plotë të tij me planin mësimor, bazën ligjore në fuqi, aktet rregullatore të miratuara nga UMSH si dhe kërkesat e tregut të punës. Nga shqyrtimi i syllabuseve , GVJ thekson se “është i nevojshëm përditësimi i vazhdueshëm i literaturës tek programet lëndore me botime të reja” pasi një pjesë e mirë e literaturës detyruese dhe të rekomanduar është jo e 5 viteve të fundit. Pasurimi i bibliotekës me libra të dedikuara lëndëve të këtij program studimi do ishte një vlerë e shtuar në rritjen e cilësisë të programit. (Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2022-2023).			
Konkluzione	GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë të studimit. Në kuadër të përditësimit dhe përmirësimit të programit të studimit, GVJ sugjeron që institucioni të vijojë me pasurimin e mëtejshëm të fondit të librave për këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” ofron njohuri dhe kompetenca teorike dhe metodologjike, si dhe aftësi të kërkimit shkencor në drejtim të shkencave politike dhe administrative në tre drejtime të profilizuara. Programi ka në fokus shpërndarjen e lëndëve dhe praktikës mësimore duke i mundësuar studentëve të programit thellim të njohurive dhe aftësive që ndihmojnë në zhvillimin e ekspertizës në profile të kërkuara nga tregu dhe të avancimit në karrierrë. Në përfundim të programit të studimit, studenti mund të ushtrojë një llojshmëri specialitetesh si nëpunës i administratës publike, qeverisjen vendore dhe politikat sociale si dhe vazhdimin e një karriere akademike, etj. <i>(Evidenca Nr.14. Plani Mësimor i programit të studimit; Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile).</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ vlerëson se organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, mundëson arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifike të programit të përcaktuar në Rregulloren e tij <i>(Evidenca Nr. 9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile; Evidenca Nr.14. Plani Mësimor i programit të studimit).</i> Shpërndarja e lëndëve realizohet përkatësisht në 2 semestra të shtrira në një vit akademik, me kreditet e orët mësimore përkatëse, përputhen me përcaktimet ligjore në fuqi dhe janë në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit të studentëve. Praktika Profesionale ka 6 kredite dhe zhvillohet në semestrin e dytë të vitit, gjithashtu realizimit të detyrimeve përmbyllëse ka 9 kredite.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e	Struktura e programit është e mirë-gërshetuar ku lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në harmoni të plotë me atë çka kërkon një program i një niveli “master profesional” si në nivelin kombëtar dhe atë rajonal. Nga shqyrtimi i Syllabuseve dhe planit mësimor, GVJ vlerëson se ato përcaktojnë

përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	qartë dhe në mënyrë eksplicite emërtimi, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë të lëndës apo modulit. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formues të programit të studimit dhe sipas përcaktimeve ligjore, duke kategorizuar veprimtaritë formuese, ku peshën kryesore e kanë lëndët/ modulet karakterizuese, të cilat janë tërësisht në përputhje me profilet e programit. <i>(Evidenca Nr.5. Strategjia e zhvillimit të programit; Evidenca Nr.14. Plani Mesimor i programit të studimit; Evidenca Nr. 14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023).</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVI konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në përfundim të studimeve i shërben arritjes së objektivave të zhvillimit profesional dhe aftësimit për tregun e punës. Gjithashtu, programi mundëson transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve, (Neni 76 i Statutit UMSH) sikurse dhe punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve pasi programi i pajis me njohuri dhe kompetenca të përshtatshme. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.5. Strategjia e zhvillimit të programit; Evidenca Nr.14. Plani Mësimor i programit të studimit)</i> Syllabuset e lëndëve në programin e studimit kanë rubrikën e kontrollit të dijeve të ndarë në: Detyra Kontrolli përgjatë semestrit 5 të tilla, Projekt kursi dhe provimin përfundimtar <i>(Evidenca Nr. 14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023).</i> Realizimi i të gjitha lëndëve, i praktikës profesionale dhe punimi i diplomës e kompletin studentin me aftësi dhe kompetenca për të kontribuar në tregun e punës.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset janë në përputhje me vendimet ligjore duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Në mënyrë periodike, institucioni u kërkon pedagogëve përditësimin e syllabuseve <i>(Evidenca Nr. 19 Syllabus)</i>. Ndërsa syllabuset përditësohen çdo vit, pjesa e literaturës së syllabuseve kërkon vëmendje të veçantë, veçanërisht për sa i përket viteve të botimit të literaturës. <i>(Evidenca Nr. 14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023).</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit	Përmbajtja e programit të studimit garanton formimin e aftësive dhe kompetencave profesionale për studiues dhe ekspert të fushës së

garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Shkencave Politike dhe Administrative. Nga shqyrtimi i syllabuseve GVJ konstaton se me përmbajtjen e tyre ato synojnë përfitim të dijeve, aftësive e kompetencave që ka si objektiva ky program studimi. <i>(Evidenca Nr. 14 Plani Mesimor i programit të studimit; Evidenca Nr. 14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023).</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit dhe syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se ky program u ofron studentëve njohuri të specializuara dhe të thelluara në fushën e Shkencave Politike dhe Administrative, siç është strukturuar e profilizuar programi, duke u dhënë mundësi studentëve të marrin baza për të vijuar me studime të mëtejshme, apo të shfrytëzojnë aksesin në tregun e punës. <i>(Evidenca Nr. 14 Plani Mësimor i programit të studimit; Evidenca Nr. 14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023; Evidenca Nr.15. Analiza e tregut të punës)</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve si dhe të kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Studimet në këtë program ofrohen me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale minimumi 1 vit akademik dhe realizohen me 60 kredite, i strukturuar në dy semestra. Lëndët, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si edhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore, ashtu sikundër janë specifikuar në Planin Mësimor mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------



Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Institucioni bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve të tij nënligjore si dhe ka një kuadër të plotë dokumentacioni si statut, rregullore, strategji, etj që orientojnë procesin e krijimit apo përmirësimit të përmbajtjes së programeve të studimit (<i>Evidenca Nr.1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca 4. Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH</i>). Instrumentat dhe baza ligjore ku mbështetet funksionimi i departamentit e përcakton atë si njësi përgjegjëse për nisjen e procesit për realizimin e përmirësimit të përmbajtjes së programit dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës. Institucioni ka infrastrukturën dhe strukturat përgjegjëse që të asistojnë departamentin për ndërmarrjen e një procesi të tillë. Raportet dhe analizat periodike që realizojnë njësitë e garantimit të cilësisë dhe sigurisë së mësimdhënies shërbejnë gjithashtu për këtë proces. Në shqyrtimin e dokumentacionit dhe bisedat me drejtuesin e departamentit GVJ vlerëson se marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private i kanë mundësuar departamentit të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca që krijohen dhe ndryshojnë herë pas here. Departamenti organizon në kuadrin e aktiviteteve institucionale aktivitete të përbashkëta me partnerët si lektorë të ftuar, apo me përfaqësues të pushtetit qendror. (<i>Evidenca Nr.15. Analiza e tregut të punës; Evidenca Nr.10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH</i>).
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Pas takimeve në institucion me stafin e departamentit, zyrat e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës dhe ajo e sigurimit të e Cilësisë, si dhe me studentët, GVJ gjykon se vlerësimi i studentëve për programin e studimit konsiderohet një burim i rëndësishëm informacioni për përmirësimin e programit të studimit. Njësia e Cilësisë (NJSBCZHK) dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ka në fokus marrjen e opinioneve të studentëve në lidhje me zhvillimin e programit dhe procesit mësimor. Zyra e Alumnit e institucionit mban kontakte me studentët e diplomuar përmes aktiviteteve periodike dhe përcjell propozimet në njësinë bazë DSHPMN. https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private



Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	UMSH në tërësi ka infrastrukturën dhe mekanizmat e bashkëpunimit me rrjete institucione publike e private për të marrë feedback që lidhet me nevojat për të përshtatur programet e studimit në përputhje me propozimet e ardhura prej tyre. DSHPMN ka kapacitete njerëzore dhe infrastrukturore që t'i përgjigjet kërkesave dhe nevojave për zhvillimin e programit të studimit dhe përshtatjen e programit kundrejt nevojave nga institucionet publike e private në nivel qëndror e lokal, në fushat e ekspertizës që mbulon ky program. (Evidenca Nr.5. Strategjia e Zhvillimit të Programit)			
Konkluzione	GVJ konkludon se UMSH ka infrastrukturën dhe bazën ligjore për përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Në shqyrtimin e dokumentacionit dhe bisedat me drejtuesin e departamentit dhe studentët konfirmohen marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucione publike dhe private, të cilat i kanë mundësuar departamentit të informohet mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës për njohuri, kompetenca dhe aftësi bashkëkohore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ vlerëson se institucioni, në të gjitha nivelet, ka hartuar dokumenta strategjik ku përfshihen qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të tij. (Evidenca Nr. 4. Plani Strategjik i Zhvillimit UMSH; Evidenca Nr. 5. Strategjia e Zhvillimit të Programit). Njësia bazë ushtron kompetenca në bazë të parashikimeve ligjore, si dhe organizon dhe bashkërendon punën institucionale dhe akademike. Realizimi i këtij synimi kërkon zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushën e formimit teorikë dhe profesional, të kërkimit shkencor si edhe në fusha të tjera me interes të ndërsjelltë. GVJ, bazuar në dokumentacionin referues dhe takimet e realizuara me drejtuesit e institucionit dhe

	stafin akademik gjykon se objektivat dhe Pani Strategjik i Zhvillimit të këtij programi Masteri Profesional janë në përshtatje të plotë me planin e zhvillimit strategjik të UMSH dhe të FDSHH. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet në përputhje me misionin dhe qëllimin e UMSH, aftësimin dhe edukimin e profesionistëve të ardhshëm që t'i përgjigjen kushteve të reja të zhvillimit të kontekstit kombëtar, rajonal e global.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies e ato kërkimore të njësive bazë. DSHPMN nxit, programon, bashkërendon, zhvillon e organizon, në nivelin e programit të studimit, punën akademike e kërkimore. Zbatimi i rregulloreve të programeve të studimit që mbulon departamenti përmban respektimin e lirisë akademike, si dhe të drejtave dhe detyrimeve e stafit akademik dhe të studentëve. Autonomia akademike konsiston në alternimin e formave të ndryshme në mësimdhënie, si: leksione të hapura nga lektorë të huaj/vendas, përfaqësues biznesesh ose institucioneve; vizita mësimore pranë bizneseve/institucioneve. <i>(Evidenca Nr. 11. Leksione të hapura DSHPMN)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Institucioni përmes kuadrit rregullator, dokumenteve strategjike, marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe vizionit të tij synon që në kuadër të realizimit të programeve të studimit të nxit, mbështet dhe angazhojë në projekte, mobilitete apo në aktivitete kërkimore studentët dhe stafin akademik. Në programet mësimore (syllabuset) krahas provimit përfundimtar janë të parashikuara 5 detyra kontrolli me 10% të vlerësimit secila, si dhe realizimi i një projekti që ka 20% të vlerësimit total. Kjo strukturë vlerësimi i mundëson studentit realizimin e një punë të vazhdueshme kërkimore dhe plotësuese. Gjithashtu përmbyllja e studimeve me punim diplome angazhon studentët në thellimin e dimensionit kërkimor. <i>(Evidenca Nr. 14. Plani Mesimor i programit të studimit).</i> Organizimi i konferencës së parë shkencore për studentët në vitin 2023 në nivel fakulteti është një hap shumë i mirë për zhvillimin e kërkimit shkencor tek studentët, krahas vizitave studimore dhe kërkimore pranë institucioneve të caktuara të organizuara nga stafi i DSHPMN. <i>(Evidenca Nr 39. Thirrja e Konferencës Studentore).</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore,	Institucioni ofron forma të ndryshme stimuluesh për stafin akademik që të përfshihen në kërkimin shkencor dhe në aktivitete të ndryshme studimore. Kërkimi shkencor mbështetet financiarisht nëpërmjet

Mase


njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ose nëpërmjet fondit institucional për financimin e publikimeve në revista ndërkombëtare përmes rimbursimit të kostove për pagesën e tarifës për botimin e një artikulli në revistë. Institucioni inkurajon dhe mbështet financiarisht pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet financimit edhe të teksteve universitare. Stafi akademik ka fituar dy projekte të financuara nga AKKSHI duke krijuar hapësira për punën kërkimore si për stafin dhe për studentët (RVB, fq.22). Po ashtu, stafi akademik është i përfshirë në projektet COST të BE për nxitjen e kërkimit shkencor dhe networkut të kërkuesve shkencore. https://www.umsh.edu.al/media/65096fdbf05d9.pdf https://www.umsh.edu.al/media/652675bac4cdf.pdf https://www.umsh.edu.al/c/74/konferenca-shkencore https://www.umsh.edu.al/c/129/botime-umsh-press			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se strukturat përgjegjëse si njësia kryesore dhe ajo bazë bëjnë të mundur realizimin e programit të studimit të lidhur me orientimin dhe fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Departamenti përgjegjës për këtë program studimi realizon objektivat e vendosura në dokumentet strategjike të zhvillimit institucional dhe kërkimit shkencor në përputhje me fushën e programit të studimit. Kërkimi shkencor mbështetet financiarisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të ndryshme ose nëpërmjet fondit institucional për financimin e publikimeve në revista ndërkombëtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit respektiv, rezultojnë se institucioni bën planifikimin strategjik me projekte që realizojnë në praktikë objektivat strategjike të fushës kërkimore. Si në nivel njësie kryesore dhe atë bazë mbështeten dhe inkurajohen bashkëpunimet përmes organizimit të aktiviteteve kërkimore-shkencore si konferenca, workshop-e apo seminare. Gjatë takimit me stafin akademik, u pohua se institucioni krijon hapësirë për angazhim në

programit të studimit në kërkim shkencor.	kërkime shkencore nëpërmjet financimit të stafit që fiton projekte post-doktorale duke i paguar paga gjatë kohës së qëndrimit jashtë vendit. <i>(Evidenca Nr.4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH. Vizita në Institucion)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësitë përgjegjëse brenda institucionit qofshin në nivel njësie kryesore, bazë apo njësia e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë informojnë stafin akademik dhe studentët për thirrjet dhe kërkesat për kryerjen e studimeve dhe analizave dhe i inkurajon ata të aplikojnë. Këto angazhime institucionale reflektohen si në dokumentet strategjike të UMSH, FDSHH dhe DSHPMN, sikurse edhe në partneritet me aktorët e tjerë duke ofruar shërbime në fushat respektive të ekspertizës. <i>(Evidenca Nr.4. Plani strategjik i zhvillimit UMSH; Vizita në institucion)</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Bazuar në vizitën në institucion dhe takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët, rezulton se FDSHH dhe DSHPMN organizojnë një sërë aktiviteteve me karakter shkencor dhe mësimor. Vizibiliteti i këtyre aktiviteteve pasqyrohet dhe në faqen zyrtare të UMSH. Në vitin 2023, në nivel fakulteti u organizua konferenca e parë shkencore për studentët, duke nxitur studentët e këtij fakulteti për përfshirje dhe pjesëmarrje. <i>(Evidenca Nr.11. Leksione të hapura DPSHPMN; Evidenca Nr.39. Thirrja e Konferencës Studentore).</i> https://ëëë.umsh.edu.al/d/199/leksion-i-hapur-shqiperia-dhe-politika-e-saj-e-jashtme-ne-kontekstin-evropian-dhe-mesdhetar https://ëëë.umsh.edu.al/d/207/loja-leksion-i-hapur-nga-eljan-tanini
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara përmes zhvillimit të njohurive bashkëkohore në shkencat politike dhe administrative nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit akademik. Kurrikula dhe përmbajtja e programit të studimit Master Profesional, është i rëndësishëm për vendin dhe proceset zhvillimore të tij. Ky program studimi formon profesionistë konkurrues për tregun e punës. <i>(Evidenca Nr.14. Plani Mësimor i programit të studimit).</i>

Maso



Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	N/A			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	N/A			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. UMSH ka strategjinë e ndërkombëtarizimit, infrastrukturën dhe bazën rregullative për nxitjen e e stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në realizimin me sukses të projekteve kërkimore shkencore në përputhje me objektivat e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Stafi akademik i DSHPMN për realizimin e programit të studimit përpiqet të harmonizojë metodat bashkëkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive (<i>vizita në institucion</i>). Rregullorja e programit të studimit dhe programet lëndore parashikojnë se gjatë mësimdhënies përfshihen të gjithë elementët formues në funksion të studentit si: leksionet, seminarët, ushtrimet, projektet dhe detyrat e kursit, praktika profesionale, përgatitja e mikrotezës, por edhe leksionet e hapura me personalitete të ftuar. <i>(Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile; Neni 17).</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Krahas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, GVJ gjatë vizitës në institucion, u njoh me këndvështrimin e studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit për procesin e mësimdhënies. Zhvillimi i orëve të leksionit realizohet përmes aplikimit të metodave interaktive, punëve individuale, diskutimeve dhe herë pas here ekspertëve të ftuar. Diskutimet në orën e seminarit dhe prezantimet i japin mundësi studentit të bëjë analiza dhe të shprehë mendimin e tij në mënyrë të pavarur. <i>(Evidenca 14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023; Vizita në institucion).</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Filozofia e institucionit dhe strukturat e tij mbështesin rritjen akademike dhe zhvillimin e metodave të suksesshme mësimore për stafin akademik. UMSH ka mundur trajnime për stafin akademik me qëllim rritjen e kapaciteteve. <i>(Evidenca Nr.28. Program i trajnimeve 2022-2023)</i> Institucioni mbështet financiarisht stafin akademik duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimujve për përmirësimin profesional. <i>(Evidenca Nr.2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UMSH)</i>

Maso



	Në kuadër të marrëdhënieve dhe marrëveshjeve të UMSH me shumë IAL vendase dhe të huaja, stafi ka hapësira për kualifikim të vazhdueshëm, në kuadër të organizimit, mbështetjes dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore, botimeve në revista, vizitave studimore, mobiliteteve, pjesëmarrjeve në leksione të hapura, etj. Personeli akademik i programit të studimit ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh në universitetet partnere evropiane si Greqi e Gjermani, apo përmes programeve të shkëmbit Erasmus+ personeli akademik ka patur mundësi të japë mësim dhe të përfitojë eksperiencë në universitetet partnere. (Evidenca Nr.58. Të dhënat mbi mobilitetet)
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Stafi akademik i departamentit është me përvojë në mësimdhënie dhe ka kualifikime shkencore që e bëjnë kompetent për modulet që zhvillon në dhënien e njohurive në kuadër të këtij programi studimi. GVJ vlerëson se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojë akademike dhe profesionale në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të lëndëve që zhvillojnë. (Evidenca Nr.14.3. CV e stafit akademik). Bazuar në Rregulloren e programit të studimit dhe infrastrukturën që ka institucioni, stafi akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin përmes nxitjes së mendimit krijues dhe zhvillimit të përgjithshëm të tij. Pedagogët përpiqen që të ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi me studentët duke i përfshirë në aktivitete akademike dhe shkencore. (Vizita në institucion).
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Institucioni ka ndërtuar praktika periodike vlerësimi në nivele të ndryshme me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe ruajtjen e cilësisë. Bazuar në aktet rregullative bazë të UMSH, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton në mënyrë periodike dokumentin me titull “Planveprimi 2022-2023 UMSH”. (Evidenca Nr.48. Plani i Punës NJSBCZHK). NJSBCZHK në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe njësitë bazë, në fund të çdo semestri organizojnë dhe plotësojnë pyetësin për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi (Evidenca Nr.25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti). Gjithashtu dhe fokus-grupet janë një tjetër instrument që përdoret për të marrë mendimet e studentëve. (Evidenca Nr.34. Procedura e punës me fokus grupet). Rezultatet e këtyre pyetësorëve bëhen pjesë e raporteve që NJSBCZHK

	përgatit, i shpërndan në departamente dhe fakultete dhe i paraqet në rektorat.			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Procesi i monitorimit të programit të studimit realizohet si në nivel institucional (NJSBCZHK), njësie kryesore dhe atë bazë. Në bazë të Statutit (kreu XI; Neni 84, Neni 85) dhe Rregullores së njësisë, NJSBCZHK (Neni 1; Neni 2) operon në nivel institucional si strukturë që monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të stafit akademik dhe realizimit të programeve të studimit. Njësia përbehet nga 9 anëtar dhe ka autonomi vepruese dhe akses për të gjitha të dhënat e institucionit (Neni 3). (Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punes NJSBCZHK.) Kjo zyrë ka kompetencë të hartojë raportet e vlerësimit të pyetësorëve të realizuar nëpërmjet njësive bazë dhe atyre kryesore, të cilët i paraqet Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe vë në dijeni drejtuesit e njësive kryesore (Neni 9 i Rregullores së sipërcituar). Kjo njësi bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me njësitë kryesore dhe bazë dhe organizojnë trajnime për personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies. Kujdes i veçantë i kushtohet trajnimit të personelit akademik të angazhuar rishtazi, sikurse u konfirmua gjatë takimit të GVJ me stafin akademik duke vënë theksin në aspektet metodike dhe të organizimit të procesit mësimor. (Evidenca Nr.48. Plani i Punës NJSBCZHK)			
Konkluzione	Institucioni përmes stafit akademik dhe infrastrukturës mbështetëse harmonizon dhe garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin. Për garantimin dhe ruajtjen e cilësisë së programeve të studimit, strukturat respektive realizojnë disa forma vlerësimi, si për studentët, stafet apo edhe vetëvlerësimi për të matur progresin e bërë në drejtim të formave sa më të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies. NJSBCZHK dhe njësia bazë mbledhin opinione, duke përfshirë studentët në këtë proces përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve. GVJ vlerëson se UMSH ka struktura institucionale që mbështesin përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, në veçanti NJSBCZHK.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Mase


Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve, njohurive, si dhe kriteret dhe komponentët e vlerësimit pasyrohen në rregulloren e programit të studimit si dhe në plan programet e çdo lënde. Dija e studentit kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogu dhe në forma të ndryshme. Studentët njoftohen mbi këtë gjatë javës së parë të fillimit të studimeve, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Çdo syllabus ka një seksion të veçantë për mënyrën e vlerësimit të lëndës. Pjesëmarrja në leksione është e detyruar në masën 75%. Testimi dhe vlerësimi i njohurive përbëhet nga dy rubrika: vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin në provim përfundimtar. Në plan programet e çdo lënde përcaktohet e kategorizuar dhe pikëzuar çdo element si vijon: Komponentët e vlerësimit: Detyrë Kontrolli 10 % Detyrë Kontrolli 10 % Detyrë Kontrolli 10 % Detyrë Kontrolli 10 % Detyrë Kontrolli 10 % Detyra/Projekte kursi 20 % Provimi përfundimtar: 30 %. Totali 100 %. Vlerësimi me notë realizohet nga 4(katër) deri në 10(dhjetë). <i>(Evidenca Nr.14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023)</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo semestër, titullari i lëndës i njeh studentët me syllabusin e lëndës që do të zhvillohet përgjatë tij. Gjatë orës së parë të zhvillimit të lëndës apo modulit pedagogu sqaron strukturën lëndore dhe komponentët e syllabusit në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve. <i>(Evidenca Nr.14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023)</i>

Masa

[Signature]

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i dijeve dhe njohurive që studentët kanë fituar përgjatë lëndës apo kursit realizohet në mënyrë të vazhdueshme. GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe takimin me studentët konfirmoi se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përdor format e kontrollit të dijes së vazhdueshme përgjatë gjithë realizimit të lëndës. Provimi me shkrim është një komponent i rëndësishëm i vlerësimit krahas komponentëve të tjerë plotësues si pjesëmarrja, detyrat e kontrollit, detyra e kursit/projektet. <i>(Evidenca Nr.14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023; Evidenca Nr.40.Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin).</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni harton rregullore dhe procedura të testimit e vlerësimit të njohurive në mënyrë të vazhdueshme duke gërshtuar punën përgjatë kursit me testimet përfundimtare. Zbatimi i procedurave të testimit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore garantohen nga stafi akademik dhe strukturat përgjegjëse që ka institucioni. Studentët njoftohen gjatë javës së parë të fillimit të studimeve nga pedagogu përkatës mbi komponentët e syllabusit dhe mënyrën e detajuar të kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve. Format e vlerësimit janë të përshkruara edhe në syllabuset e lëndëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një kontrolli të vazhdueshëm të shprehura si përqindje e notës përfundimtare. UMSH ka një strukturë që përvijon kontrollin e vazhdueshëm të dijes gjatë vitit. Kjo reflektohet kryesisht në ndarjen e angazhimit dhe përfshirjen e studentëve në diskutime gjatë seminareve me detyra kontrolli përgjatë zhvillimit të lëndës, detyrave të kursit/projektet dhe provimit të kontrollit të dijes përfundimtare. Bazuar në Rregulloren e Departamentit në nenin 18 “Kontrolli i Dijes” thuhet se “Forma kryesore e kontrollit të dijes



	është provimi...Provimi mund të bëhet: a) me shkrim, b) me gojë, c) i kombinuar, e shrim dhe gojë". (Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN) Rregullorja po në nenin 18 përcakton gjithashtu parimet e kriterëve të vlerësimit për kursin, si edhe tabelën e vlerësimit të notave. Pavarësisht specifikave të lëndës apo fokusit të pedagogut në vlerësimin e komponentëve të caktuar, tesimi i njohurive bëhet gjatë të gjithë kursit duke u bazuar mbi elementë të ndryshëm siç janë pjesëmarrja aktive, përgatitja e projekteve apo prezantimeve, testimi me shkrim/gojë apo i kombinuar. Kjo shihet në shpërndarjen e vlerësimit përfundimtar në disa zëra dhe peshën e vlerësimit që ka secili komponent, përcaktuar qartë në rregulloren e programit dhe syllabuseve duke u harmonizuar me kërkesat e lëndës. (Evidenca Nr.14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UMSH ka mbështetur përdorimin e sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit, në përputhje me mundësitë e aplikimit të tyre në programet e studimit me qëllim sigurimin e origjinalitetit të përgjigjeve dhe transparencës së vlerësimit. Institucioni ka nxitur pedagogët të vënë në zbatim formatet elektronike (quiz assignment) google form, të testimit dhe vlerësimit të provimeve, duke ofruar trajnime dhe udhëzues të posçëm. Disa prej tyre vazhdojnë të përdoren dhe që lidhen me vlerësimin e vazhdueshëm në platformën google classroom. (Evidenca Nr.35. Manual i përdorimit të platformave elektronike. RVB, fq.29)
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bazohet në vlerësimin e të mësuarit të studentit gjatë të gjithë kursit, e shprehur në komponentët e cituar me sipër, duke bërë një përlogaritje të pikëve dhe përqindjes respektive të secilit prej tyre. Vlerësimi del në përputhje me rregulloren e UMSH. Komponentët e vlerësimit me pikët dhe përqindjen përkatëse përbëjnë një seksion të veçantë në syllabusin e lëndës, i cili ju shpjegohet studentëve në orët e para të fillimit të lëndës. Kjo mënyrë vlerësimi është parashikuar në statut, rregulloren e UMSH. Procedurat e vlerësimit përfundimtar të njohurive bëhet nga titullari i lëndës sipas përcaktimeve në aktet rregullative të institucionit dhe departamentit. Procesverbali final mban firmën e pedagogut, shefit të departamentit, kryesekretares dhe dekanit. (Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN; Evidenca Nr.14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023)

Masa



Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Aktet rregullative të institucionit përcaktojnë që tezat e provimit të kenë një seksion të veçantë ku pedagogu mund të bëjë komente për secilën pyetje. Sikundër dhe gjatë vlerësimit të komponentëve të ndryshëm të syllabusit si prezantimi i detyrave të kontrollit, projekteve etj pedagogu bën komentet përkatëse me fokus rrijten përmbajtësore të njohurive dhe aktivizimin e studentëve. Pedagogu i lëndës i komunikon studentit në javën e fundit të semestrit nivelin e pikëve të vlerësimit të vazhduar të fituara gjatë semestrit. Në kuadrin e vlerësimit të vazhduar çdo komponent i vlerësimit të njohurive argumentohet nga ana e stafit akademik dhe për këtë njoftohet studenti. <i>(Evidenca Nr.2. Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca Nr.7. Rregullore e FDSHH; Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN.)</i> Në korrigjimin që i bëhet tezave të provimit pedagogu komenton dhe eidenton të gjitha plotësimet/mos plotësimet që lidhen me trajtimin e tezës.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregulloret në të gjitha nivelet e institucionit përcaktojnë që kopjimi dhe plagjatura nuk tolerohet. Procesi i provimeve monitorohet nga të paktën dy pedagogë, të cilët caktohen nga departamenti. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur. Po ashtu bëhen përpjekje për të shmangur plagjiaturën kur studentët dorëzojnë projekte, ese ose teza përfunduese për diplomën master. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ nuk eidenton instrumente apo përdorimin e ndonjë platform elektronike specifike që e eidenton dhe shmang plagjiaturën. <i>GVJ sygjeron që në të ardhmen institucioni të planifikojë marrjen e një programi elektronik anti-plagjaturë.</i> <i>(Evidenca Nr.7. Rregullore e FDSHH).</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në dokumentacionin respektiv dhe vizitën në institucion, GVJ konfirmon se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë. Procesi i sekretimit të provimit garanton vlerësimin objektiv të njohurive të studentit bazuar në punën e tij; korrigjimi i provimit bëhet nga pedagogët e lëndës nën drejtimin e titullarit të lëndës. Nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Studentit (SMS), pedagogu hedh në procesverbalin analitik (online) pikët sipas komponentëve përkatës, brenda pesë ditëve nga zhvillimi i provimit, pas korrigjimit të provimit. <i>(Evidenca Nr.7. Rregullore e FDSHH; Evidenca Nr.40. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin; Vizita në institucion)</i>

Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar dhe transparente përsa i takon njohjes së studentëve me rezultatet e kontrollit të dijes. Rezultati paraprak i provimit i bëhet i ditur në kohë reale studentëve nëpërmjet sistemit SMS në llogarinë personale të tyre. Pas ditës së pestë të zhvillimit të provimit, organizohen seancat sqaruese me studentët dhe komisionin e vlerësimit para hartimit të procesverbalit përfundimtar. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të provimit, nëse studenti nuk është dakord me vlerësimin, ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim, që dorëzohet në sekretarinë mësimore të fakultetit dhe ndiqet nga njësia përgjegjëse. Pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve përfundimtare të provimeve. <i>(Evidenca Nr.2. Rregullore e Organizimit UMSH; Evidenca Nr.7. Rregullore e FDSHH; Evidenca Nr8. Rregullore e DSHPMN).</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në aktet rregullatore brenda UMSH është e parashikuar një procedurë ankimi ku parashikohen hapat që ndjek studenti për rivlerësimin e provimit. Kjo procedurë vlerësohet nga një komision i ngritur posaçërisht. Ky komision në bazë të kërkesës procedon me ballafaqimin e provimit e përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Nga vizita në institucion u pa se studentët e këtij programi studimi nuk kanë patur raste ankimi të rezultateve të vlerësimit. <i>(Evidenca Nr.7. Rregullore e FDSHH; Evidenca Nr.40. Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin; Vizita në institucion).</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se institucioni ka përcaktuar në aktet rregullative procedura që sigurojnë vlerësim të drejtë dhe transparent. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit. Rezultati paraprak i provimit i bëhet i ditur studentëve nëpërmjet sistemit SMS në llogarinë personale në kohë reale. Pas ditës së pestë nga realizimi i provimit, vijohet me seancat sqaruese me studentët dhe komisionin e vlerësimit para hartimit të procesverbalit përfundimtar. Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit përkatës përmes një ankese me shkrim, e cila ndiqet nga njësia përgjegjëse. Këto informacione u vërtetuan edhe nga bisedat me studentët edhe stafit akademik. Gjithashtu përsa i përket mekanizmave anti-plagjaturë. GVJ sygjeron që në të ardhmen

	<i>institucioni të planifikojë marrjen e një programi elektronik anti-plagjaturë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Strategjia e zhvillimit të programit të studimit dhe kurrikula e programit është hartuar duke mbajtur në konsideratë zhvillimet bashkëkohore falë edhe profilit akademik të pedagogëve, shumica e të cilëve janë me eksperiencë akademike dhe kualifikime që lidhen me njësinë bazë ku operojnë. Stafi akademik cilësor krijon mundësi që kurrikula e programit të zhvillohet në standarde të larta përmes lëndëve përkatëse me fokus formimin e studentëve duke konsideruar edhe nevojat e tregut të punës (<i>Evidenca Nr. 5. Strategjia e Zhvillimit të Programit</i>). Programi i studimit i lejon studentit që të krijojë profilin e tij profesional por dhe akademik duke i dhenë mundësi për studime të thelluar në fushat respective. Në kuadër të programit të studimit studentët janë gjithashtu të angazhuar në aktivitete të ndryshme kërkimore dhe shkencore që i përgatit ata të thellojnë kompetencat dhe aftësitë e tyre. Përmirësimi i vazhdueshëm i lëndëve me literaturën dhe me format bashkëkohore të mësimdhënies garanton përfitimin e njohurive duke gërrshetur analizat konceptuale në fushën e studimit me formimin kërkimor të përgjithshëm në përputhje me kërkesat e programit të studimit (<i>Evidenca Nr. 14. Plani Mesimor i programit të studimit</i>).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit parashikon që transmetimi i njohurive tek studentët, të kryhet nëpërmjet angazhimit të tyre në punë konkrete nëpërmjet detyrave të kursit, punimeve të ndryshme, përgatitjeve për testim etj. Stafi akademik kujdeset që krahas njohurive në kuadër të lëndës, studenti të mbahet aktiv përgjatë gjithë semestrit. GVJ pas takimit me studentët e programit të studimit vlerëson se ky program Masteri Profesional ofron zhvillimin e aftësive në fushën specifike të shkencave politike dhe Administrative dhe profileve të saj. Aftësitë e veçanta orientohen kah zhvillimit të kapaciteteve analitike të studentëve dhe formimin e tyre, aftësi

	komunikimi, si dhe zgjeron perspektivën në fushën studimore Ky program nuk përfshin lëndë në gjuhë të huaj. <i>(Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile; Evidenca Nr.14. Plani Mesimor i programit te studimit).</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e syllabuseve të lëndëve dhe për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit. Njohuritë dhe aftësitë që zhvillon studenti gjatë vitit akademik analizohen përgjatë gjithë semestrit nga pedagogu dhe në përfundim të lëndës jepet vlersimi i përmbledhur në të gjithë komponentët e tij. Kjo analizë e njohurive të përfituara por edhe asaj që mbetet ende për tu bërë ndihmon studentit për ti adresuar sugjerimet në vijim të studimit akademik. Pedagogët kanë takime të vazhdueshme me studentët dhe në këto konsultime ofrohen sugjerimet përkatëse për përmirësimin e punës me studentët <i>(Vizita në institucion).</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Baza rregullative ku mbështetet funksionimi i departamentit dhe puna e stafit akademik për realizimin e programeve të studimit është e plotë dhe me kërkesa të larta në drejtim të cilësisë së mësimdhënies. <i>(Evidenca Nr. 5. Strategjia e Zhvillimit te Programit).</i> Stafi akademik për realizimin e procesit të mësimdhënies mbështetet si në aspektin teorik dhe atë praktik. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materialet shtesë, literatura e rekomanduar, apo raste studimore që mund të trajtohen në varësi të lëndës. Përfshirja e praktikës është gjithashtu një komponent i rëndësishëm për gërshetimin e njohurive me praktikën në institucione. UMSH ka traditë në zhvillimin e leksioneve të hapura me personalitete politike dhe konferencave shkencore mbi strategjitë e zhvillimit të vendit. Zhvillimi i praktikës profesionale i mundëson studentit aplikimin e njohurive teorike në praktikë dhe i ofron atij një mundësi për lidhje me tregun e punës. Ndërkohë që ka ndërlidhje mes lëndëve dhe praktikës profesionale, kjo e fundit po zhvillohet në semestrin e fundit të studimeve, gjë që nuk lejon reflektime të mëtejshme mbi rezultatet e praktikës me të nxënësit në kuadër të lëndëve. <i>(Evidenca Nr.11. Leksione të hapura DPSHPMN).</i> https://www.umsh.edu.al/d/199/leksion-i-hapur-shqiperia-dhe-politika-e-saj-e-jashtme-ne-kontekstin-evropian-dhe-mesdhetar

	https://ëëë.umsh.edu.al/d/207/loja-leksion-i-hapur-nga-eljan-tanini
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në fillim viti akademik hartohet plani i aktiviteteve/ leksioneve të hapura, me angazhimin e personelit akademik të departamentit dhe në bashkëpunim me departamentet e tjera të UMSH. Staf i akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura për të informuar kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit të disiplinave dhe fushave të tyre të studimit. Institucioni organizon konferenca shkencore dhe aktivitete jashtë kurrikulare të cilat janë të hapura për studentët. Një praktikë pozitive është dhe përfshirja e personaliteteve të ftuar për të mbajtur leksione të hapura për çështje bashkëkohore që prekin jetën e vendit dhe tema me interes për studentët. <i>(Evidenca Nr.11. Leksione të hapura DPSHPMN).</i> https://www.umsh.edu.al/d/199/leksion-i-hapur-shqiperia-dhe-politika-e-saj-e-jashtme-ne-kontekstin-evropian-dhe-mesdhetar
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Personeli akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore në kuadër të projekteve apo nismave në nivel departamenti dhe më gjërë. Programi i studimit mundëson angazhimin e studentëve në realizimin e detyrave të kontrollit, projekteve si dhe përgatitjen e punimit të diplomës duke i mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. Në këto studime që ata kryejnë, mbështeten gjerësisht nga personeli akademik i angazhuar në programin e studimit. Institucioni përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit apo marrëveshjet e shkëmbimit Erasmus + mundëson dhe hapësira për studentët që të marrin pjesë në mobilitete apo projektet. <i>(Evidenca Nr.10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH)</i> Gjithashtu organizimi i konferencës studentore është një mundësi tjetër për zhvillimin e ideve inovative dhe punës kërkimore të studentëve. <i>(Evidenca 39. Thirrje e konferencës studentore).</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet harmonizimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kërkimin shkencor, studimet në terren, praktikave profesionale. Institucioni ka struktura e mekanizma në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit. Studentët marrin pjesë edhe në projektet apo</i>



	<i>marrëveshjet e shkëmbimit Erasmus+ dhe kompetencat e tyre profesionale i manifestojnë në konferencat studentore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në Rregulloren e programit të studimit përkatësisht Kreu VI, Neni 24 përcaktohet ndër të tjera se: “Diplomimi bëhet me punim diplome ose me provim përfundimtar formimi”. Në nivel institucional është hartuar një dokument në formatin e një “Guide” mbi temat e diplomave të programeve master në UMSH duke detajuar hap pas hapi procedurat për realizimin e detyrimeve përmbyllëse. (Evidenca Nr.21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës). Studentët duhet që fillimisht të përmbyllin të gjitha detyrimet akademike dhe të kenë shlyer detyrimet financiare në mënyrë që të realizojnë prezantimin e punimit. (Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile). https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Drejtuesi i Departamentit dhe stafi akademik, por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet, afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Departamenti shqyrton kërkesat e studentëve për punim diplome dhe përgatit listën e temave dhe pedagogët përkatës e cila miratohet nga Dekani. Studenti udhëhiqet nga pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit të fushës që ka zgjedhur studentit. Studenti asistohet përmes takimeve të drejtpërdrejta, komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës. (Evidenca 6. Rregullore e FDSHH; (Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile; https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit, RVB, Vizita në institucion).

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në RVB, studentët e programit të studimit Master Profesional realizojnë mbrojtjen e diplomës vetëm përmes punimit të diplomës. (RVB, fq.35) Ndërkohë në Rregulloren e programit të studimit sikundër është evidentuar dhe më lart, detyrimet përmbyllëse realizohen “me punim diplome ose me provim përfundimtar formimi”, duke bërë diferencën midis Masterit Profesional dhe Masterit Shkencor që kërkon detyrimisht punim diploma. (Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile).
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Megjithëse në RVB thuhet se ky kriter nuk aplikohet, GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion konfirmon se ky proces realizohet. Studentët propozojnë pedagogun dhe temën që duan të zhvillojnë në përputhje me interesat e tyre. Departamenti realizon procesin dhe studenti merr informacion mbi procedurën, stilin dhe mënyrën e paraqitjes së temës dhe asistohet nga udhëheqësi i diplomës për realizimin e saj. Nga biseda me studentët ata ende nuk i kishin përcaktuar temat e diplomave, por ishin të kënaqur me disponibilitetin e pedagogëve të tyre. (RVB, Vizita në institucion). https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni ka vendosur në dispozicion të studentëve laboratorë mësimorë-kërkimorë, biblioteka dhe mjedise të përshtatshme ku ata i përdorin për kryerjen e praktikave të tyre mësimore, zhvillimin e projekteve mësimore dhe projekteve kërkimore. Në mënyrë specifike mbikëqyrësit dhe drejtuesi i departamentit, i ndihmojnë studentët të kenë akses në institucione të ndryshme, veçanërisht kur ka nevojë për kryerjen e anketave apo mbledhjen e informacioneve kërkimore. (RVB)
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Detyrimet përmbyllëse kanë 9 kredite dhe mund të realizohen me provim /punim diplome(ne RVB gabimisht është shkruar 8 kredite). Studenti paraqet punën përmes një prezantimi përpara komisionit të miratuar. Në bazë të performancës komisioni vendos për notën pas mbrojtjes së diplomës. Vlerësimi me notë realizohet duke konsideruar krahas prezantimit të punës nga studenti dhe

	vlerësimin e udhëheqësit, oponentit, dhe tre anëtarëve të komisionit para të cilit bëhet prezantimi i tezës. (RVB, Evidenca Nr.21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës). https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të realizimit të detyrimeve akademike, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, të miratura nga ministria përgjegjëse për arsimin. Procedurat e lëshimit të diplomës përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion një kopje zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, bazuar në rregulloret dhe procedurat institucionale. Suplementi i diplomës përmban të gjithë elementët e programit të studimit. (Evidenca Nr.49. Model i Diplomes per programin e studimit; Evidenca Nr.50. Modeli i Suplementit te diplomes per programin).			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Krahas Rregullores së institucionit, njërive kryesore dhe atyre bazë, ka dhe një rregullore dedikuar punës dhe detyrave të sekretarisë mësimore. (Evidenca Nr.46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore) Studentët pajisen me dokumentat përkatëse sikurse parashikon ligji. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve dhe siguron mbrojtjen e tyre sipas legjislacionit në fuqi. Pas mbylljes së studimeve, dosja e studentit arkivohet dhe UMSH ruan kopje të dokumentacionit të studentit sipas legjislacionit në fuqi dhe rast pas rasti ia ofron ato studentit nëse ai i kërkon.			
Konkluzione	Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga stafi i departamenti ashtu edhe nga udhëheqësi i diplomës. Në përfundim të studimeve, UMSH e përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë diplomën edhe suplementin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfuturit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione publike dhe private me të cilat bashkëpunon dhe për kryerjen e praktikës profesionale. <i>(Evidenca Nr.10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH)</i> Procesi i përzgjedhjes së institucionit realizohet në bashkëpunim me studentin dhe mundësi që ka institucioni. Institucioni garanton mjedise brenda dhe jashtë tij, të përshtatshme për realizimin e praktikës profesionale.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfuturimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet.			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Bazuar në dokumentin “Udhëzimi për praktikrat dhe formularët...” përcaktohen të gjitha hapat dhe procedurat që lidhen me përbushjen e këtij procesi. <i>(Evidenca Nr.13. Udhëzues për praktikrat dhe Formularët)</i> . Praktika konsiderohet si lëndë e programit të studimit dhe quhet e likuiduar pas frekuentimit dhe vlerësimit me notë. Studenti në master vlerësohet në bazë të dosjes së plotësuar dhe formatet e miratuara. Komisioni për vlerësimin e praktikës caktohet nga njësa bazë. <i>(Evidenca Nr.13. Udhëzues për praktikrat dhe Formularët, fq.6-7)</i>			
Konkluzione	Institucioni garanton mjedise brenda dhe jashtë tij, të përshtatshme për realizimin e praktikës profesionale. <i>Për shkak të natyrës së programit të studimit, (ku kriteri 2 nuk është i aplikueshëm) Standardi aplikohet pjesërisht për këtë program. Kjo gjë nuk çënon arritjen e standardit në tërësi.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																		
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik, vizitën e realizuar në institucion, bisedat me stafin akademik dhe me personelin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ konfirmon se UMSH dhe më specifikisht në programin Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” ka të angazhuar personelin akademik me tituj dhe grada. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohet në realizimin e programeve të studimit pranë Departamentit të Shkencave Politike e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Në realizimin e programit të studimit, përgjatë viteve akademike është angazhuar stafi akademik me kualifikimin si në vijim:																																		
	<table><tr><th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2022 - 2023</th><th colspan="2">2023 - 2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>4</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Në total</td><td>5</td><td>0</td><td>5</td><td>0</td></tr></table>	Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	-	-	-	-	Prof.As.Dr	1	-	1	-	Dr/PhD	4	-	4	-	Msc	-	-	-	-	Në total	5	0	5	0
Tituj/grada	2022 - 2023		2023 - 2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr	-	-	-	-																															
Prof.As.Dr	1	-	1	-																															
Dr/PhD	4	-	4	-																															
Msc	-	-	-	-																															
Në total	5	0	5	0																															

Masa

[Signature]

	Për të dhënat e paraqitura sa më lart, GVJ i është referuar të dhënave sikurse paraqitur nga IAL në dokumentacionin shtesë. Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit rezulton se profili i ekspertizës së stafit akademik është në përshtatje me lëndët e këtij ofruara në këtë program studimi. Fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik janë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka një eksperiencë disavjeçare edhe në fushën kërkimore siç vërtetohet edhe nga botimet, grupe kërkimore e shkencore sipas fushave specifike që mbulojnë. <i>(Evidenca Nr.14.3. CV e stafit akademik të programit të studimit).</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Shpërndarja e ngarkesës mësimor realizohet bazuar në planin e miratuar në fillim të çdo viti akademik. GVJ konfirmon se, për këtë program studimi, personeli akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies, me kohë të plotë dhe të pjesshme, përmbush kërkesat ligjore në fuqi lidhur me ngarkesën mësimore. Stafi akademik efektiv mbulon nga 2-3 lëndë mësimore si brenda programeve të departament edhe në programet e departamenteve të tjera. Fusha akademike e tyre është në përputhje me modulet dhe lëndët ku ata janë aktivizuar. <i>(Evidenca Nr.16. Permbledhese e tabelave per programin e studimit; Evidenca Nr.14.3. CV e stafit akademik të programit të studimit).</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Për periudhën e akreditimit, dëshmohet qëndrueshmëri e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”. Kjo konstatohet nga shqyrtimi i dosjeve të stafit akademik dhe dokumentacioni në lidhje me kontratat e punës etj. Dosjet e personelit të vëna në dispozicion gjatë takimit me ZBNJ përfshijnë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë personelin akademik. <i>(Vizita në institucion).</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e	Bazuar në aktet e brendshme rregullative, institucioni garanton dhe ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e duhur të stafit. Nga bisedat e GVJ me drejtuesit e institucionit, stafin akademik dhe nga shqyrtimi i dosjeve, doli qartë se Zyra e Burimeve Njerëzore bazuar në

personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	nevojat e njësisë bazë ndjek procedura të rregullta rekrutimi dhe vlerësimi. Kjo zyrë ka përgjegjësi për zbatimin e kriterëve në rekrutimin dhe vlerësimin e stafit akademik, që nga kriteret e përgjithshme deri tek kriteret specifike sipas rastit të cilat bëhen publike në faqen online të UMSH, rrjete sociale zyrtare etj. Zyra e Burimeve Njerëzore e publikon shpalljen për vendet vakante, duke specifikuar nivelin e kualifikimit, detyrat e vendit të punës, dokumentacionin e kërkuar (CV e hollësishme në gjuhën shqipe, Letër motivimi; Kopje të listës së notave, Kopje të dëshmisë së gradës shkencore/titujve akademikë). <i>(Evidenca Nr.2. Rregullore e Organizimit UMSH. Evidenca Nr.29. Permbledhje e procedures se rekrutimit)</i> https://www.umsh.edu.al/d/160/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Për natyrën e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, dhe për realizimin e tij nuk ka nevojë për orë laboratorike apo për mjedise të tjera specifike mësimore. Në kurrikulën e programit të studimit nuk parashikohen orë laboratorike dhe nuk ka nevojë për laboratorë specifike. Gjithsesi, institucioni ka investuar në laboratorë, salla leksioni dhe mjediset e tjera të mësimdhënies të cilat janë të pajisura me infrastrukturë moderne dhe pajisje teknologjike të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të lëndëve, aftësimit teorik e praktik dhe objektivave formues të programit të studimit. <i>(Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN).</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit	Zyra e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe njësitë bazë realizon mbledhjen e të dhënave dhe përpunon statistikën mbi stafin në mënyrë periodike për çdo vit akademik. ZBNJ përditëson çdo vit të dhënat e stafit në nivel institucional dhe ruan dosjet individuale të të gjithë personelit. Këto të dhëna administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>(Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN).</i>

akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione, ndërmarrje dhe organizata (<i>Evidenca Nr. Evidenca 10. Marrëveshjet e bashkëpunimit UMSH</i>). Në Rregulloren e Praktikës Mësimore përcaktohen strukturat përgjegjëse të praktikës mësimore dhe procesi i zhvillimit të praktikës mësimore. Gjithashtu institucioni ka një zyrë të titulluar “Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës” që realizon orientimin apo udhëzimin e tyre drejtë institucioneve publike apo sipërmarrjeve private duke i drejtuar studentët drejtë tregut të punës. (<i>Evidenca Nr.38. Rregullore e ZKSK</i>).
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Zhvillimi i praktikës mësimore është i rëndësishëm dhe institucioni merr masat për realizimin e tij sa më mirë. Në nivel institucional si për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve është hartuar një dokument “Guide” për hapat dhe procedurat që duhet të ndiqen për zhvillimin e praktikës mësimore. Bashkëpunimi që nevojitet për këtë proces kërkon anagazhim si nga stafi i universitetit dhe nga stafi i institucionit pritës. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve. Qëllimi i realizimit sa më korrekt i praktikës mësimore lidhet me aftësimin e studentëve për të realizuar aplikimin e njohurive praktike dhe atyre kërkimore. (<i>Evidenca Nr.13. Udhëzim për praktikat dhe Formularët e praktikës mësimore</i>)
Konkluzione	Referuar vitit akademik 2022-2023, IAL ka angazhuar në këtë program studimi 11 personel akademik efektiv dhe 5 me kontratë. GVJ konfirmon se, për këtë program studimi, personeli akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies, me kohë të plotë dhe të pjesshme, përmbush kërkesat ligjore në fuqi lidhur me profilin akademik dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Zyra e Burimeve Njerëzore ka të përcaktuara qartë rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik dhe mbështetës të angazhuar në këtë programi studimi. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione, ndërmarrje dhe

	<i>organizata të ndryshme për realizimin e praktikave profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UMSH garanton mundësi të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore pasi institucioni ka kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe didaktik, në përputhje me natyrën e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”. Mjediset janë shumë të mira dhe të përshtatshme për klasa leksioni/seminari, zyra për stafin, biblioteka në funksion të zhvillimit sipas parametrave bashkëkohore të programit të studimit. Kampusi është një godinë me 5 kate mbi sipërfaqë dhe një katë nëntokë e ndërtuar në vitin 2010 me sipërfaqe totale 3860 m ² . Në ambjentet e institucionit ka ëi-fi dhe akses në internet. <i>(Evidenca Nr.27. Relacion i Verifikimit te Godines)</i> Të gjitha këto mjedise u panë nga GJV gjatë vizitës në institucion. UMSH plotëson normativën e sipërfaqes dhe vëllimit të shfrytëzueshëm për student, si dhe ka kushte shumë të mira dhe siguron ngrohje dhe ftohje në të gjithë godinën si dhe përmbush kërkesat për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit. <i>(Evidenca Nr.17. Urdhër për Higjenën dhe zjarrin)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e	Mjediset mësimore infrastrukturore të UMSH janë të pajisura me teknologjinë e fundit dhe garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, në përputhje me programin e studimit. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje teknologjike (tabela whiteboard dhe mundësi për videoprojektor) që lehtësojnë procesin e mësimdhënies-mësimnxënies në auditorët e universitetit. I gjithë kampusi është i mbështetur me pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera dhe me rrjet ëi-fi në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ <i>(Vizita në</i>



teknologji ve bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<i>institucion</i>). Institucioni garanton akses dhe lëvizje për studentët me aftësi ndryshe përmes ashensorit, rampave të pjerrëta dhe sinjalistikave të nevojshme. (RVB, fq.42)
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Kushtet e ambienteve në UMSH janë të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të programit mësimor të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” për aftësimin teorik e praktik të studentëve dhe arrijtjen e objektivave formuese të programit të studimit. Mësimi zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete bashkëkohore duke krijuar mundësi për paraqitjen e materialeve të ndryshme (<i>Vizita në institucion</i>). UMSH disponon laboratorë të teknologjisë së informacionit, ku përveç aktivitetit mësimor, departamenti organizon aktivitete ekstrakurrikulare si konferencat studentore apo projektet e kurseve të studentëve duke përmbytur objektivat formues të programit të studimit në tërësi. (RVB, fq.42) https://usia.al/u-sia-laboratory-inauguration-at-the-mediterranean-university-of-albania-mua/
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nuk aplikohet
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë	Nuk aplikohet

strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	Institucioni ka ambiente të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” si për aftësimin teorik (për arritjen e objektivave formuese) dhe atë praktik (praktika profesionale) të studentëve. Mësimi zhvillohet në salla leksioni të pajisura me infrastrukturë dhe mjete bashkëkohore. <i>Nga analiza e bazuar në dokumentacionin e paraqitur, takimet dhe vizita në UMSH, GVJ konkludon se institucioni garanton dhe vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimor të këtij programi studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Biblioteka e UMSH ndodhet në katin 1 nëntokë (bodrum) dhe është e përbërë nga 2 salla me nga 107 m² me ambiente leximi dhe ambientin e fondit të librave. (Evidenca Nr.27. Relacion i Verifikimit të Godines). Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike (4,200 tituj librash) dhe atë digjitale (327,000 tituj librash elektronik) (RVB, fq.43). Gjatë vizitës në institucion, GVJ pa ambientet e Bibliotekës, literaturën respektive dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët, si dhe shqyrtimin e dokumentacionit konkludon se studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion. (Evidenca Nr.43. Materiale për Bibliotekën). GVJ vlerëson se në mbështetje të programit të studimit nevojitet përditësimi i literaturës së syllabuseve me tituj të viteve të fundit dhe pasurimi i fondit të bibliotekës në formatin fizik (libra) të literaturës së përditësuar. Një numër i konsiderueshëm i materialeve në bibliotekën e UMSH janë të fushës ekonomike, dhe i përshtaten programit të studimit Master profesional.

	http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	UMSH nxit njësitë kryesore dhe ato bazë të evidentojnë nevojat e tyre në lidhje me pasurimin e fondit të librave në institucion. Departamenti paraqet kërkesat për shtimin e librave në bibliotekë dhe propozon çdo vit literatura sipas syllabuseve të programeve të studimit. Pas pandemisë COVID-19 strukturat respektive janë fokusuar më tepër në literaturën online dhe jo pasurimin e fondit të bibliotekës me libra fizik. Një pjesë e titujve të rinj të shtuar në fondin e bibliotekës janë botime të personelit akademik të UMSH. (Evidenca Nr.43. Materiale për Bibliotekën).
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e UMSH është pjesë e Electronic Information for Libraries. Studentët e UMSH kanë mundësi të shfrytëzojnë fondin elektronik të bibliotekës. Biblioteka ka hapësira të cilat mund të shfrytëzohen nga studentët e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”. Strukturat brenda UMSH garantojnë akses të barabartë për studentë.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	UMSH është pjesë e Electronic Information for Libraries, si dhe ka akses për përdorimin e platformës elektronike Edëard Elgar Publishing. Platforma është e aksesueshme për studentët edhe stafin akademik brenda ambienteteve të Universitetit. Platforma elektronike Edëard Elgar Publishing mundëson libra dhe revista elektronike për të gjitha programet e studimit në UMSH. Nga fillimi i vitit 2022, biblioteka është e anëtarësuar në COBISS me të drejta të plota. (Evidenca Nr.43. Materiale për Bibliotekën) https://www.elgaronline.com/broëse?access=user&level=parent https://al.cobiss.net/ http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UMSH ka hapësira dhe mundësi brenda ambjenteteve të institucionit për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë të bibliotekës elektronike, si për studentët edhe stafin akademik. Mjediset e bibliotekës janë të pajisura me pajisje teknologjike që mundësojnë dhe shpejtojnë kërkimin e shpejtë të literaturës fizike e digjitale. (Vizita në institucion) https://www.elgaronline.com/broëse?access=user&level=parent https://al.cobiss.net/

Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka ofron akses në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë (poste leximi dhe PC) në bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga institucioni. Biblioteka e UMSH është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online) dhe ka akses në platforma elektronike si Edëard Elgar Publishing. Biblioteka e ndodhet në katin nëntokë dhe ka hapësira me poste leximi dhe kompjutera të mjaftueshme për studentët e këtij programi masteri. Gjithashtu në godinën e institucionit mund të shfrytëzohen edhe laboratorët me kompjutera për aksesimin e bibliotekës online. <i>(Vizita në institucion)</i> https://www.elgaronline.com/broëse?access=user&level=parent https://al.cobiss.net/
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Akresi në bibliotekë sigurohet në orare të përshtatura me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe mbështetur në nevojat e studentëve. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në faqen online të universitetit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi aksesin dhe plotësimin e nevojave të studentëve për përdorimin e bibliotekës.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe	UMSH vit pas viti realizon pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë dhe përmes abonimeve në bibliotekat digjitale krijon infrastrukturën për rritjen e aksesimit në këto biblioteka. Procedurat e pasurimit të bibliotekës, janë të përcaktuara në dokumentat që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. Gjatë vizitës në institucion, në vizitën në bibliotekë u njohëm me kartela të studentëve dhe personelit akademik, të cilat e dëshmonin shkallën e mjaftueshme të shfrytëzimit. Çdo student dhe lektor ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave për burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik. Me shfrytëzimin e sistemeve open access, biblioteka e institucionit ka siguruar mundësi të mëdha për studentët dhe stafin. <i>(Evidenca RVB; Vizita në institucion).</i>

atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>Në pjesën më të madhe të tij, programi i studimit përmban literaturën e nevojshme në mbështetje të mësimdhënies që ju mundëson stafëve akademike t'i referojnë në syllabuset dhe studentëve t'i përdorin ato. GVJ propozon se në mbështetje të programit të studimit dhe rritje së cilësisë nevojitet përditësimi i literaturës së syllabuseve me tituj të viteve të fundit dhe pasurimi i fondit të bibliotekës në formatin fizik (libra) të literaturës së përditësuar. Në tërësi, biblioteka e UMSH është e pajisur me literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe atë të huaj në mbështetje të programit të studimit, të cilat plotësohen nga aksesit në platformat digjitale që janë pa pagesë si për stafet akademike dhe studentët. Mjediset mbështetëse të bibliotekës, kompjuterat, aksesit në internet kapërcejnë kufizimet e fondit fizik të burimeve të informacionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon një system elektronik të menaxhimit të studentëve i quajtur SMS.UMSH i cili mbështet studentin në procesin mësimor dhe shërben për komunikimin e brendshëm. Ky sistem përfshin komunikimin online për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe ju mundëson informim në kohë reale lidhur me aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim. Administrimi i informacionit në këtë platformë realizohet në mënyrë korrekte, duke i shërbyer stafit akademik dhe studentëve për të parë ecurinë e punës së tyre. (Evidenca Nr.35. Manual i përdorimit të platformave elektronike) http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar Strukturat akademike dhe ndihmës akademike në UMSH, sigurojnë administrimin e të gjithë informacionit në lidhje me studentët. Sekretaritë mësimore asistojnë dhe administrojnë të dhënat e

Maso

[Signature]

	studentëve që nga procesi i regjistrimit e deri në përfundim të ciklit të studimit. Njësitë kryesore dhe ato bazë si dhe zyrat e tjera brenda institucionit informojnë studentët në mënyrë të vazhdueshme mbi një sërë procesesh të jetës universitare si platformat online, orarin mësimor, kurrikula, strukturat lëndore, mundësi për mobilitete apo praktika profesionale përgjatë gjithë realizimit të ciklit të studimit. <i>(Vizita në institucion; Evidenca Nr.46. Rregullore e Sekretarisë Mësimore).</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Njësia përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ është Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë disponon në dy versione atë në hardcopy dhe elektronik dosjen e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ. <i>(Evidenca Nr.35. Manual i përdorimit të platformave elektronike).</i> Gjatë vizitës në institucion, zyra e Burimeve Njerëzore i vuri në dispozicion GJV bazën e të dhënave që përmbante dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë, personelit ndihmës-akademik, etj. Zyra e Burimeve Njerëzore realizon përditësimin e dosjeve të stafit bazuar në kërkesat dhe ndryshimet ligjore të Republikës së Shqipërisë. <i>(Vizita në institucion).</i> Përsa i takon regjistrave të lëndëve dhe procesverbalet e provimeve, ato administrohen nga Sekretaria Mësimore. <i>(RVB, Vizita në institucion).</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit sigurohet akses i dedikuar nëpërmjet logimit me kredencialet personale në sistemin elektronik sms.umsh.edu.al. Sistemi është i ndërtuar me pjesë dhe me disa nivele akses. Ky sistemi është funksional që nga viti akademik 2017 e në vijim. Sistemi sms.umsh përfshin informacionin bazë si regjistrimin e studentët në lëndët e tyre përkatëse, akses në literaturën e lëndëve që ndjekin, rregullore dhe çdo gjë që lidhet me programin e studimit. Sistemi mundëson ndërveprim midis hallkave të ndryshme brenda institucionit. <i>(Evidenca Nr.35. Manual i përdorimit të platformave elektronike).</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe	Krahas Sistemit të Menaxhimit të Studentëve SMS-UMSH ku studenti ka akses në informacionet në kohë reale dhe pa pasur nevojë të kontaktojë drejtpërdrejt njësitë përkatëse, gjatë vitit 2020 institucioni ndërtoi dhe aktivizoi edhe sisteme të tjera komunikimi si: G-Suite dhe sistemi Zoom Cloud meeting. <i>(RVB, fq.47).</i>

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i Menaxhimit të Studentëve SMS-UMSH garanton informacionet mbi aktivitetet akademike e administrative në kohë reale. Drejtuesit e institucionit dhe përgjegjësi i Departamentit marrin periodikisht raportet individuale mbi prezencën e stafit në orarin e duhur, raportet individuale për kërkimin shkencor, raportet individuale për cilësinë në mësimdhënie, raportet mbi frekuentimin e studentëve sipas afatit të përcaktuar në rregulloren e programit. (Evidenca Nr.35. Manual i përdorimit të platformave elektronike; RVB).		
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni ka faqjen e tij zyrtare online. Faqa online e UMSH përmban të gjithë informacionin që lidhet me misionin e institucionit, programet e studimit, stafin akademik, aktivitete, njoftime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Informacioni i faqes dhe të dhënat respektive përditësohen në mënyrë periodike. https://www.umsh.edu.al/eng		
Konkluzione	UMSH disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion në kohë reale të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Faqja online e UMSH është në dy gjuhë shqip dhe anglisht, si dhe e pasur me informacionin e kërkuar nga studentët, personeli akademik dhe publikun e interesuar.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për	UMSH ndjek një politikë të kujdesshme të garantimit të qëndrueshmërisë financiare. Institucioni planifikon përdorimin e burimeve financiare në hapa dhe procedura të mirëpërcaktuara në

Maso

programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	kuadrin rregullator të tij. Identifikimi i nevojave dhe burimeve fillon nga njësia bazë duke kaluar të gjitha hallkat deri tek Bordi i Administrimit. Mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe atyre bazë, administratori i UMSH harton projekt-buxhetin vjetor dhe propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale. Brenda muajit dhjetor Bordi i Administrimit miraton buxhetin që përfshin vitin e ri akademik. Çdo ndryshim në buxhet bëhet duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e institucionit. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e Organizimit të UMSH; Evidenca Nr.19.1 Tabela e Raportit Financiar; Evidenca 19.2 Pasqyrat Financiare; RVB, fq.48).</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Bordi i administrimit është organi më i lartë kolegjal i UMSH. Plani financiar i ndërtuar në nivel institucional sipas strukturave respektive përmban të gjithë elementet dhe zërat specifik për financimin e tij, si: shpenzime për staf administrativ, orët mësimore të realizuara nga stafi akademik, mbështetja për kualifikimeve afatshkurtra dhe afatmesme, projektet, aktivitete shkencore, shpenzimet e ndryshme operative, etj. Zyra e Menaxhimit Financiar është struktura përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit në të gjitha hallkat e saj. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e Organizimit të UMSH;; Evidenca 19.2 Pasqyrat Financiare; RVB, fq.48)</i> Burimet financiare të institucionit janë: të ardhurat nga tarifat, të ardhura nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe të ardhura nga burime të tjera. <i>(Evidenca Nr.19.1 Tabela e Raportit Financiar).</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni kryen auditim periodik të përvitshëm. Institucioni angazhon për këtë proces një kompani të jashtme dhe të çertifikuar auditimi. Raporti i auditit të jashtëm fokusohet në kërkesat ligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të cilat sikundër përcaktohen nga legjislacioni në fuqi janë publike. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin

	në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. <i>(Evidenca Nr.2. Rregullore e Organizimit të UMSH; Evidenca Nr.19.1 Tabela e Raportit Financiar; Evidenca 19.2 Pasqyrat Financiare; Evidenca Nr.19.3 Raporti i Auditit).</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UMSH ndjek një politikë transparente të përdorimit të burimeve financiare dhe analizon periodikisht treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare. Financimi dhe menaxhimi sa më i mirë i burimeve financiare siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Për secilin vit akademik institucioni harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi duke bërë të mundur evidentimin e elementeve kryesore që ndikojnë në performancën e qëndrueshme dhe rezultative të institucionit. Administratori evidenton dhe korrigjon shmangiet e përkohshme që mund të ketë për zëra të veçantë të buxhetit dhe bëhen ndryshimet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Organizimit të UMSH. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e Organizimit të UMSH).</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Burimet e financimit që institucioni disponon bëjnë të mundur qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”, si dhe garanton kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Institucioni dhe strukturat si në nivel njësie kryesore dhe ato bazë kanë objektiv hartimin dhe aplikimin për projekte kërkimore kombëtare dhe të huaja. Qëllimi është marrja e të ardhura shtesë në rast financimi çka përkthehet në të ardhura plus për institucionin. <i>(Evidenca Nr.19.1 Tabela e Raportit Financiar; Evidenca 19.2 Pasqyrat Financiare; Evidenca Nr.19.3 Raporti i Auditit, Vizita në institucion).</i>
Konkluzione	<i>UMSH garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit përmes tarifave studentore, financimet nga projektet, si dhe burime të tjera. UMSH në mënyrë periodike harton raportin financiar për kostot e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Për mbulimin e ciklit të plotë akademik të studentëve UMSH i përmbahet dispozitave ligjore në fuqi si Ligji i Arsimit të Lartë, udhëzimi “Për Miratimin e Kalendarit për Procedurat e Aplikimit dhe Rregjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë për Vitin Akademik Pasardhës”, por dhe rregulloret të brendshme të hartuara nga institucioni. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online në broshurën informuese, si edhe i ofrohet studentëve gjatë procesit të këshillimit në institucion (https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit). Pas regjistrimit të gjithë studentët pajisen me numër matriculimi nga QSHA dhe ecuria e tyre ndiqet gjatë të gjithë procesit mësimor deri kur përfundojnë studimet. <i>(Evidenca Nr. 7. Rregullore e FDSHH; Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN).</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe	Kriteret dhe procedurat kryhen nëpërmjet një procesi transparent të vlerësimit dhe përzgjedhjes së aplikantëve duke respektuar kuotat e pranimit, përfshirë këtu edhe kuota për kategori të veçanta si për studentë nga trojet, pakicat kombëtare, me status jetimi si dhe personat me aftësi të veçanta. Bazuar në statut dhe akte të tjera

Masa

studentët e programit të studimit.	rregullatore, UMSH garanton barazi dhe të drejta të njëjta në hyrje dhe në dalje për të gjithë kandidatët si dhe përgjatë të gjithë ciklit të studimit. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti UMSH).</i> Të gjitha ambientet dhe godinat e institucionit janë pajisur me ashensorë ose me rampa për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara <i>(Vizita në institucion).</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Institucioni harton dhe zbaton në regjistrimin e studentëve në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të propozuara nga Departamenti dhe të miratuara nga Senati Akademik që përcakton numrin maksimal të studentëve për secilin program studimi, si edhe në respekt të legjislacionit në fuqi siç janë: Ligji 80/2015. Kriteret publikohen në faqen online të UMSH dhe në ambientet e institucionit. Kriteret hartohen nga njësitë bazë dhe përcillen tek strukturat përgjegjëse për miratim në zbatim të kuadrit rregullator të institucionit. <i>(Evidenca Nr.7. Rregullore e FDSHH).</i> https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimi https://www.umsh.edu.al/c/152/fituesit https://www.umsh.edu.al/c/109/si-te-aplikojme
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Pranimi në programet e studimit të Ciklit të Dytë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve dhe plotëson kriteret e pranimi në universitet në përputhje me nenin 76 të ligjit nr. 80/2015. Në rastin e studentëve me diplomë të huaj është i nevojshëm ekuivalentimi i diplomës sipas dispozitave në fuqi apo edhe i krediteve në rast se transferohen nga një institucion tjetër i arsimit të lartë <i>(Evidenca Nr. 1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN).</i> Kriteret dhe procedurat e programit të studimit janë të aksesueshme nëpërmjet mjeteve dhe kanaleve formale të komunikimit për studentët dhe të gjithë të interesuarit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës koordinon punën për informimin e studentëve duke organizuar aktivitete, orë të hapura dhe panaire me qëllim prezantimin e kriterëve për secilin program studimi. Faqja online e UMSH dhe broshurat informative ofrojnë informacione mbi programin e studimit, kriteret e pranimi dhe mënyrën e aplikimit. <i>(Evidenca Nr.38. Rregullore ZKSK).</i>

	https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimi
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UMSH ka hartuar dhe publikon në mënyrë të vazhdueshme kritere të qarta për studentët me aftësi ndryshe dhe ka miratuar Rregulloren për Studentët me aftësi ndryshe. Për këtë kategori studentësh në godinat e UMSH është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme për të lehtësuar lëvizjen e tyre si ashensore, të cilët i provoi edhe GVJ gjatë vizitës në institucion. (RVB, fq.51)
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<i>Nuk aplikohet për këtë program studimi</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UMSH i kushton rëndësi të vazhdueshme kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve dhe ofron mbështetje financiare pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar pranë zyrës përkatëse në respekt të legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të institucionit për shtresat në nevojë. Sipas rasteve specifike dhe kërkesave të studentëve në formularin e tyre të aplikimit institucioni vlerëson dhe alokon bursa për kategori sociale të veçanta për studentë nga shtresa dhe komunitete të marginalizuara dhe studentë me aftësi ndryshe. UMSH, aplikon kategori të ndryshme bursash si për studimet Bachelor dhe Master. Kategoritë e bursave që ofrohen nga UMSH janë: a) bursat sociale; b) bursat e ekselencës; c) bursat e talentit dhe sportit; d) bursat mbështetëse. Vetëm për vitin akademik 2022-2023 institucioni ka akorduar bursa të plota dhe të pjesshme për 62% të studentëve, të regjistruar në të gjitha ciklet e studimit. (RVB, faqe 52) https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat
Konkluzione	<i>UMSH ka hartuar dhe zbaton procedura dhe politika të qarta për pranimin e studentëve në programet akademike, përzgjedhjen e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi. UMSH ka një legjislacionin të qartë dhe transparent për transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. UMSH ka hartuar dhe publikon në mënyrë të vazhdueshme kritere të qarta për studentët me aftësi ndryshe si dhe shtresat e marginalizuara dhe ka miratuar Rregulloren për Studentët me aftësi ndryshe. Në faqen</i>

	zyrtare të UMSH janë të publikuara edhe politikat për bursat studentore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studenti njihet me rregulloren e programit dhe aktet e tjera normative, të cilat përcaktojnë kriteret e kalimit nga një vit akademik në tjetrin në varësi të përmbushjes së kërkesave akademike. Informacioni zyrtar mbi notat është pjesë e sistemit të menaxhimit të studentëve dhe aplikohet nëpërmjet sistemit SMS-UMSH në të cilin ka akses edhe stafi akademik për tu njohur me rezultatet e studentëve, për të verifikuar ecurinë e studentëve, dhe për të bërë këshillimet e nevojshme mbi progresin akademik. Stafi i angazhuar në realizimin e programit të studimit, në javën e parë të çdo fillim semestri i bënë studentët me dije në lidhje me programin, lëndët, kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe përgjatë vitit sekretaria mësimore dhe departamenti informon studentët për orarin mësimor, frekuentimin, rezultatet e provimeve. (Evidenca 22. Udhëzuesi i Studentit) https://www.umsh.edu.al/c/145/studentet http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Nëpërmjet dokumentave rregullatore, studentët marrin informacion mbi procedurat e njohjes së diplomës, kualifikimeve të mëparshme, si dhe udhëzime mbi procedurat e transferimit duke shpjeguar kriteret për njohjen e krediteve dhe duke informuar më pas studentin për kreditet e njohura. Kriteret dhe procedurat për njohjen e studimeve dhe kualifikimeve të mëparshme, të plota ose të pjesshme, janë të përcaktuara në Rregulloren e UMSH, në rregulloret e programit të studimit dhe të njëjseve bazë e kryesore, sipas sistemit të krediteve. (Evidenca Nr.7. Rregullore e FDSHH;Evidenca Nr.22. Udhëzues i studentit) https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	UMSH operon në bazë të legjislacionit vendas në përputhje me sistemin Evropian të Arsimit të Lartë të Krediteve si njësi matëse e ngarkesës akademike. Mënyrat e vlerësimit të njohurive të programit si edhe kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në Rregulloren e Programit dhe specifikohen në një seksion të veçantë të syllabusit të programit (<i>Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit te Studimit MP me profile</i>). Dijet e përfituara në një lëndë vlerësohen duke u bazuar në provimin përfundimtar, pjesëmarrjen aktive të studentit në klasë si edhe komponentë të tjerë si detyra kontrolli, projekte etj dhe i behen me dije studentëve që në javën e parë të programit (<i>Evidenca Nr. 14.2 Syllabuset e lendeve 2022-2023</i>).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e programit është përcaktuar se studentët finalizojnë procesin e studimit nëpërmjet punimit të temës së diplomës apo një provimi përfundimtar. DSHPMN mbështetur në rregulloren e programit të studimit, në listën e fushave të ekspertizës dhe temave orientuese për diplomat informon studentët në muajin dhjetor te vitit akademik mbi procesin dhe i vë në dispozicion udhëzuesin për përgatitjen e punimit të diplomës. Studentet informohen në lidhje me hapat, kriteret e procedurat e punimit të diplomës. Informacioni gjendet edhe në faqen zyrtare të UMSH. (<i>Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit te Studimit MP me profile; Evidenca Nr.21. Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i>). https://www.umsh.edu.al/c/215/procesi-i-diplomimit
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Strukturat brenda institucionit ku në veçanti, njësia bazë sëbashku me ZKSK realizojnë informimin dhe orientimin e studentëve të rinj. Në fillim të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, studentët informohen për të gjitha detajet e programit të studimit përmes një sërë veprimtarish informuese që institucioni organizon. UMSH realizon takime të hapura për tërheqjen e studentëve potencialë për ciklet e ndryshme të studimit. Pasqyrimi i ofertës akademike mundësohet dhe në faqen zyrtare të UMSH ku janë të sqaruara kriteret e pranimit dhe mënyrën e aplikimit. https://www.umsh.edu.al/d/19/keshillimi-i-karrieres
Konkluzione	UMSH ofron mjete të ndryshme për njohjen e programit nga ana e studentëve dhe këto përfshijnë si transparencën online me informacion të hollësishëm për programin e studimit, javën hyrëse ku pedagogët pjesëmarrës japin informacionin e nevojshëm, apo edhe Zyrën për Kujdesin ndaj Studentit që shërbejnë si pikë reference për të dhënë një informacion të plotë e të hollësishëm mbi

	njohjen e programit të studimit, përparimin akademik, njohjen e krediteve, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin në fjalë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	ZKSK informon studentët mbi strukturën e programeve duke harmonizuar takimet në zyrë me informacionin në faqen zyrtare. Gjithashtu, stafi akademik i njësisë bazë, sekretaria mësimore, koordinatori i programeve master informon dhe orienton studentët mbi planin mësimor, mbi strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Informacioni mbi programin e studimit gjendet dhe në faqen zyrtare të institucionit https://www.umsh.edu.al e cila është e aksesueshme për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu në mjediset e institucionit ka stenda me broshura për ofertën akademike të tij. (Evidenca Nr.36. Broshura e programeve Master). http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Përveç informacionit të ofruar në faqen e internetit dhe nga strukturat përkatëse në momentin e regjistrimit, studentit i ofrohet i gjithë informacioni i nevojshëm si p.sh. syllabuset që në javën e parë të studimeve. Strukturat respektive kujdesen për ti informuar studentët mbi planin mësimor, modulet, përmbajtjen e lëndëve, nivelin e detyrueshëm të frekuencimit, format e kontrollit të njohurive, literatura bazë dhe e rekomanduar. Studentët informohen gjithashtu edhe për akreditimin e programeve dhe të institucionit dhe vlefshmërinë e diplomës. (Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile). https://www.umsh.edu.al
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si	Zyrat Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës informojnë studentët për mundësitë e punësimit apo praktikave mësimore që mund të ndjekin pranë institucioneve të ndryshme. DSHPMN në

dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	bashkëpunim me koordinatorin e programeve master dhe njësitë e tjera organizative të UMSH, ndihmon studentët që të aftësohen për të aplikuar për punë, pjesëmarrje në panaire, organizime takimesh me profesionistë të fushës/ studentë alumni, trajnime etj. (Evidenca Nr.38. Rregullore e ZKSK; RVB, fq.55)			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	UMSH vë në dispozicion të studentëve informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e programit të studimit dhe procesit mësimor. Faqen zyrtare e UMSH gjithashtu ka informacion të plotë dhe të aksesueshëm për të gjithë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ pa mjediset dhe infrastrukturën e institucionit i cili krijon të gjitha kushtet për zhvillimin e procesit mësimor në Masterin Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore”. (Evidenca Nr.36. Broshura e studimeve Master; Vizita në institucion).			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Pasi studentët rregjistrohen në UMSH, struktura brenda institucionit i pajisin me kredenciale për të patur akses në sistemin e menaxhimit të studentit. Sistemi i siguron atyre informacion që lidhet me performancën akademike, materiale, mungesat e kryera, apo dhe aspekte financiare. Nëpërmjet faqes zyrtare online të UMSH secili student dhe pedagog ka llogarinë e tij dhe ky sistem ka të gjitha dokumentacionet në shërbim të programit të studimit, të aksesueshme lehtësisht nga studentët. http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Konkluzione	Programet e studimit dhe syllabuset përkatëse janë në dispozicion të studentëve duke përfshirë si format e vlerësimit, objektivat mësimore që pritet të arrihen në përfundim të kursit, si edhe mënyrën e vlerësimit të përmbyshjes së këtyre objektivave formuese. Struktura dhe organizimi i programit janë publike dhe mund të aksesohen nga studenti si online ashtu edhe nëpërmjet broshurave apo edhe komunikimit me stafin akademik të programit.			
Shkalla e përmbyshjes së standardit	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Në nenin 88 të Statutit të UMSH përcaktohet “Baza e të dhënave të studentëve UMSH”. Statistikat mbi numrin e studentëve, shpërndarjen e tyre sipas programeve, notat e marra, studentët e diplomuar apo edhe të punësuar përditësohen çdo vit nga strukturat respektive brenda UMSH. Sekretaria Mësimore ka përgjegjësinë të mbledh të dhëna statistikore vjetore lidhur me numrin e studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar në programin e studimit. (Evidenca Nr.1 Statuti UMSH; Evidenca Nr.46 Rregullore e Sekretarisë Mësimore)																
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sistemi i menaxhimit (SMS) të të dhënave mundëson përditësimin dhe hedhjen e të dhënave personale të studentëve për secilin program studimi si ecurinë akademike, regjistrimet, transferimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje, etj. Në këtë mënyrë krijohet një tablo në kohë reale e studentëve që janë në programet e studimit. Sekretaria Mësimore mban statistika vjetore të përditësuara mbi numrin e studentëve të cilët janë regjistruar në programin e studimit Master Profesional. Në dokumentacionin zyrtar sekretaria shënon dhe rastet e shkëputjes apo largimet para përfundimit të programit, ata që nuk i kanë përfunduar ende studimet me sukses atë vit akademik si dhe të diplomuarit. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike janë si mëposhtë:																
	<table><tr><th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar</th><th>Transferime</th><th>Totali</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>35 studentë- Profili Administratë Publike; 3 studentë- Profili Politika Sociale</td><td>0</td><td>38 studentë</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>28 studentë - Profili Administratë Publike</td><td>0</td><td>28 studentë</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>20 studentë- Profili Administratë</td><td>0</td><td>22 studentë</td></tr></table>	Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Totali	2020-2021	35 studentë- Profili Administratë Publike; 3 studentë- Profili Politika Sociale	0	38 studentë	2021-2022	28 studentë - Profili Administratë Publike	0	28 studentë	2022-2023	20 studentë- Profili Administratë	0	22 studentë
Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Totali														
2020-2021	35 studentë- Profili Administratë Publike; 3 studentë- Profili Politika Sociale	0	38 studentë														
2021-2022	28 studentë - Profili Administratë Publike	0	28 studentë														
2022-2023	20 studentë- Profili Administratë	0	22 studentë														




	Publike dhe 2 studentë- Profili Politika Sociale		
<i>Evidenca dokumentet shitesë "Nr. i të rregjistruarve".</i>			
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga Sekretaria Mësimore përmes sistemit të brendshëm të informacionit. Shkëmbimi i të dhënave sipas rastit realizohet me anë të komunikimit zyrtar midis drejtuesit të Departamentit dhe sekretarisë. Të dhënat statistikore të studentëve janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. <i>(Evidenca Nr.46 Rregullore e Sekretarisë Mësimore).</i>		
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ konstaton se UMSH ka të përcaktuar me akte ligjore të gjithë funksionimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore mbi studentët në hyrje dhe në dalje. Institucioni kryen kontrollin periodik në të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e tyre. Gjithashtu UMSH vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që ruhet dhe disponohet nga këto njësi përgjegjëse, në lidhje me studentët dhe veprimtarinë e tyre në institucion. Mbajtja, menaxhimi dhe siguria e tyre është një kërkesë ligjore e normuar nga aktet rregullatore të universitetit. <i>(Evidenca Nr.46 Rregullore e Sekretarisë Mësimore).</i>		
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamentit disponon të dhënat e nevojshme për realizimin e analizave dhe evidentimin e nevojave për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Në evidencat e vëna në dispozicion në nivel institucional është realizuar dokumenti "Analizës të tregut të punës" lidhur me ofertën akademike të UMSH në të gjitha ciklet e studimit. <i>(Evidenca Nr.15. Analiza e tregut te punes). Në të ardhmen njësia bazë të realizojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</i>		

Konkluzione	<i>Strukturat e UMSH bëjnë një punë të vazhdueshme për të mbledhur, administruar, përditësuar dhe ruajtur të dhëna të hollësishme lidhur me numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, shoqëruar me të dhëna për punësimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Rregullores dhe Statutit të UMSH, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjiale dhe vendimmarrëse sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Përfshirja dhe angazhimi i studentëve ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese bëhet sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të institucionit. Ata janë anëtarë më të drejtë vote njësoj si personeli akademik. Përfaqësimi i tyre është në organe si Senati Akademik i UMSH (Neni 11 i Statutit UMSH), Këshillin Studentor, pjesë e RVB-ve etj. Në Statutin e UMSH neni 83 “Këshillat e Studentëve” parashikohet organizimi i studentëve në këto struktura që koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH. Institucioni financo veprimtarinë e tyre. https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët vlerësojnë pedagogët më të cilët kanë zhvilluar mësim përpara përfundimit të çdo semestri duke patur parasysh cilësinë e mësimdhënies, literaturën e vënë në dispozicion, ndihmën e ofruar studentëve etj. Një student është gjithashtu pjesë e grupit të punës për hartimin e raportit të Vlerësimit të Brendshëm gjatë procesit të akreditimit. (Evidenca Nr.25. Formular i vlerësimit të pedagogut dhe të lëndës nga studenti; Vizita në institucion)
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e	Përveç plotësimit të pyetësorit dhe pjesëmarrjes në fokus grupe për tema të caktuara, studentët kontribuojnë gjithashtu edhe nëpërmjet opinioneve të shprehura në takimet me stafin akademik të

hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	departamentit në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. <i>(Takim me Studentët e Programit)</i> .			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u mundësohet si një e drejtë e tyre njohja me procedurën e zhvillimit të kontrollit të dijeve, tezën e provimit pas korrigjimit dhe mënyrën e vlerësimit (njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë) si dhe të drejtën e ankimimit. Student ka të drejtë të ankohet për procedurën e zhvillimit të provimit dhe rezultatin e tij përfundimtar. <i>(Evidenca Nr.7. Rregullore e FDSHH; Evidenca Nr.8. Rregullore e DSHPMN; Evidenca Nr.9. Rregullore e Programit të Studimit MP me profile).</i>			
Konkluzione	<i>UMSH i kushton rëndësi mbledhjes së informacionit nga ana e studentëve dhe kjo arrihet si nëpërmjet pyetësorëve të lëndës ashtu edhe procesit të ankimit apo prurjes së sugjerimeve nga ana e studentëve me fokus-grupe tematike. Kjo realizohet falë përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, që veprojnë në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Ky proces zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me përfshirjen e të gjitha organeve të universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme	Institucioni ka një njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve të quajtur “Zyra e Këshillimit Studentëve

Masa

[Signature]

në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	dhe Karrierës”. ZKSK-ja funksionon në bazë të rregulloreve dhe në përputhje me udhëzimet dhe vendimet e organeve përkatëse të institucionit dhe Ministrisë së Arsimit, ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në rregulloren e kësaj zyre. <i>(Evidenca Nr.38. Rregullore e ZKSK)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyra e Këshillimit Studentëve dhe Karrierës informon studentët përmes e-maileve, takimeve në zyrë, broshurave apo përmes informacionit të vënë në dispozicion në faqen e internetit lidhur me karakteristikat e programeve të studimit. Studentët mund të kenë edhe takim me pedagogët apo pjesëtarët e stafit akademik përgjegjës për programin, dhe kanë mundësi të marrin informacion lidhur me planin mësimor, syllabuset e lëndëve, datat e provimeve etj <i>(Vizita në institucion)</i> .
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ka si funksion parësor të saj orientimin e studentëve gjatë ciklit të plotë akademik, ofrimin e mundësive për praktikat profesionale dhe trajnime për përfshirjen e studentëve në tregun e punës. Zyra vepron edhe duke aktivizuar rrjetet alumni të të diplomuarve për tu sjellë studentëve modele pozitive. Nëpërmjet ofrit të mundësive për praktikat profesionale duke përdorur marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga ana e institucionit, studentëve ju jepet edhe një mundësi punësimi bazuar në aftësitë që ata demonstrojnë. <i>(Evidenca Nr.38. Rregullore e ZKSK).</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	ZKSK mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar në UMSH. ZKSK vlerëson bashkëpunim me ALUMNI dhe realizon aktivitete duke i sjellë disa prej tyre si modele suksesi për të motivuar edhe studentët aktualë me ecurinë e karrierës së tyre profesionale mbas përfundimit të studimeve. Studentët e diplomuar konsiderohen si “ambasadorët” e universitetit në profesionet për të cilat janë përgatitur <i>(Evidenca 45. Raporti i Zyrës ALUMNI)</i> . Ata janë një urë lidhëse midis programit të studimi dhe tregut të punës. <i>(Evidenca Nr.38. Rregullore e ZKSK; RVB, fq.59-60).</i>

	https://ëëë.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni https://ëëë.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private			
Konkluzione	UMSH ka procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve siç janë pedagogët e departamentit të cilët së bashku me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët. Një procedurë e veçantë siguron menaxhimin e ankimeve e problematikave, nga zyrat përkatëse të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton se UMSH, ka në fokus të punës së tij zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies dhe të nxënies, duke nxitur mendimin krijues e kritik të studentit duke përforur formën interaktive me në qendër studentin, si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme. GVJ vlerëson që UMSH ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ka krijuar strukturat përgjegjëse si NJSBCZHK dhe aktet rregullative mbi bazën e të cilave garanton zhvillimin e metodave interaktive të mësimdhënies. Institucioni ka

	hartuar udhëzues në nivel institucional me qëllim që të garantojë përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në të gjitha fushat e studimit. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti i UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e organizimit UMSH; Evidenca 48. Plani i Punes NJSBCZHK)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ, nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i evidencave, konstaton se në UMSH është ngritur dhe funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave në nivel institucional. Strukturat përgjegjëse përdorin forma nga më të ndryshmet për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik. NJSBCZHK i vuri në dispozicion GVJ formularë të aplikuar në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatori i programit vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik si përmes formularëve të vetëvlerësimit, të vlerësimit nga drejtuesit dhe nga studentët për çdo lëndë në fund të semestrit, sikurse edhe mbi bazën e treguesve të aktivitetit të tyre shkencor. Në kuadrin e projekteve të ndryshme stafet akademike motivohen e trajnohen për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe njohjen e metodave inovative. <i>(Evidenca Nr.25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti; Evidenca Nr.31. Formular i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues; Evidenca Nr.48. Plani i Punes NJSBCZHK)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	UMSH nxit përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies duke e konsideruar si një shtytës për të arritur objektivat e mësimdhënies <i>(Evidenca Nr.48. Plani i Punes NJSBCZHK)</i>. Këto pyetësorë, së bashku me pjesëmarrjen e studentëve në fokus-grupe apo departament, jo vetëm që përmirësojnë metodologjitë mësimore, por edhe sjellin në vëmendje pakënaqësitë e studentëve, ndërsa mënyra për të shprehur shqetësimet apo sugjerimet e studentëve ekziston nëpërmjet procesit të ankimimit në lidhje me procesin e mësimdhënies por jo vetëm. NJSBCZHK zhvillon takime të përmuajshme me Këshillin Studentor, kjo njësi zhvillon focus grupe me studentët e çdo programi studimi ku diskutojnë për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët.

	(Evidenca Nr.25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti; Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punes NJSBCZHK)			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Përgjegjësi i Departamentit gjatë takimit në institucion konfirmoi se ai i komunikoi në mbledhje rezultatet e përgjithshme dhe pastaj çdo pedagogu në veçanti ato specifike. Mbi bazën e analizës së rezultateve të anketimit, departamenti nxjerr problematikat dhe reagon për përmirësimin e tyre. UMSH përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve. (Vizita në institucion) https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Për të nxitur zhvillimin profesional të stafit, UMSH, në çdo vit akademik, krijon mundësinë për trajnimet e stafit duke u bazuar edhe në rezultatet e vlerësimit dhe konkluzionet e raporteve të njëjësive të kontrollit të cilësisë duke përcaktuar objektivat e tyre për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Gjatë takimit me stafin akademik, na u përcoll fakti që institucioni i mbështet në avancimin e tyre përmes marrjes së gradave Doktor, Prof.Asoc. dhe Profesor. Të gjitha vlerësimet që kanë të bëjnë me përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies administrohen nga Rektorati në mënyrë që ti shërbejnë promovimit në nivel institucional të modeleve më të mira.			
Konkluzione	Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet krijimit të strukturave përkatëse siç është NJSBCZHK, metodologjitë dhe mjetet përkatëse për të zhvilluar këtë monitorim, si edhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të monitorimit. Përmes projekteve të ndryshme, UMSH mbështet promovimin e vazhdueshëm të rritjes së stafit akademik dhe të njohjes së praktikave më të mira.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton se UMSH në zbatim të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, në dokumentet e tij zyrtare si Statut, rregullore etj., ka përcaktuar qartë strukturat dhe funksionet e tyre, që mbulojnë sigurimin e cilësisë. Në UMSH është ngritur struktura e sigurimit të cilësisë, dhe janë hartuar politika të qartë lidhur me procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve. NJSBCZHK në nivel institucioni synon planifikimin e përmirësimit të vazhdueshëm të UMSH dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësimin dhe ruajtjen e cilësisë. Kjo strukturë në nivel institucioni harton strategji dhe ndërton politika dhe procedura për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë për programet e studimit që ofrohen në të.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Struktura e sigurimit të cilësisë, NJSBCZHK funksionon në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, statutit të institucionit dhe rregulloreve përkatëse. NJSBCZHK përbëhet nga 9 anëtarë të cilët janë personel akademik me kohë të plotë dhe ndihmës akademik/dhe ose ekspert të fushave të ndryshme si dhe një përfaqësues i studentëve. <i>(Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punes NJSBCZHK)</i> Detyrat dhe aktiviteti i NJSBCZHK është i shumëanshëm dhe parashikohet në nenin 6, 7, 8, 9, 10 të Rregullores së organizimit dhe punes NJSBCZHK. Në bashkëpunim edhe me drejtuesit e njësive kryesorë dhe atyre bazë realizojnë procedurën e aplikimit, koordinimit dhe realizimit të akreditimeve institucionale. UMSH zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <i>(Evidenca Nr.48. Plani i Punes NJSBCZHK)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë	UMSH përdor instrumente dhe tregues të ndryshëm për sigurimin e jashtëm të cilësisë përmes proceseve të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit në bashkëpunim me ASCAL. UMSH e ka kaluar me sukses akreditimin e jashtëm institucional. Bazuar në evidencat e dosjes së RVB, UMSH ka dhënë tregues të matshëm dhe procedurat shprehen qartësisht në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, sikurse specifikohet edhe në RVB. NJSBCZHK përdor instrumenta dhe metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta që përmirësojnë cilësinë e programit të studimit.

cilësinë në programin e studimit.	(Evidenca Nr.1. Statuti i UMSH; Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punes NJSBCZHK; Evidenca Nr.48. Plani i Punes NJSBCZHK)			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ gjykon se institucioni përdor tregues të ndryshëm të qartë dhe të matshëm si për mësimdhënie edhe kërkim shkencor për vlerësimin e cilësisë. Ato pasqyrohen në raportet e NJSBCZHK, në strategjitë institucionale, në evidencat statistikore dhe në formatet e vlerësimit të stafit akademik. Rezultatet e anketimeve të studentëve tregojnë matjet e performancës së pedagogëve sipas disa kriterëve të standartizuara në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. (Evidenca Nr.1. Statuti i UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e organizimit UMSH; Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punes NJSBCZHK; Evidenca Nr.48. Plani i Punes NJSBCZHK) https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise			
Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në shqyrtimin e politikave, strukturave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. UMSH harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit duke harmonizuar forma të ndryshme të monitorimit, si anketat e studentëve, vetëvlerësimi i pedagogëve apo vlerësimi nga kolegët e tyre, rezultate të cilat harmonizohen në raportet përkatëse dhe zbatohen me udhëzimet e nevojshme nga strukturat e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për	Programet e studimit janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm në funksion të rritjes së cilësisë. Mbashtetur në aktet institucionale si Statuti, Rregullore dhe të objektivave të strategjisë së UMSH dhe të strategjisë së programit të studimit, dhe NJSBCZHK konfirmon

Maso

27

shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	se program i studimi Masteri Profesional ka kaluar në procese shqyrtimi për profilizimin sa më të qartë përmes rishikimit të lëndëve, syllabuseve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Pjesë e këtij procesi janë edhe vlerësimet e studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve të dokumentuara në raportet përkatëse si dhe raportet e vlerësimit të stafit akademik. Rezultatet e vlerësimeve u përcillen autoriteteve përgjegjëse, në mënyrë që të gjithë të njihen me arritjet apo dobësitë dhe janë transparente dhe të aksesueshëm për këdo në faqen online të UMSH. https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf https://www.umsh.edu.al/media/64ba73a87246c.pdf
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Vlerësimet periodike shoqërohen me raporte dhe gjetje rreth rezultateve të monitorimit dhe i përcillen hallkave të institucionit. Marrja dhe përpunimi i feedback-ut të studentëve përmes pyetësorëve, fokus-grupeve përgjatë vitit akademik, kontributi i Këshillit Studentor, si edhe komunikimi i vazhdueshëm i studentëve me pedagogët krijon mundësinë e përfshirjes së pritshmërive në objektivat e të ardhmes për ruajtjen e cilesisë dhe përmirësimin të vazhdueshëm në nivel programi. (<i>Evidenca Nr.25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti; Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punes NJSBCZHK</i>). Raportet e vlerësimit nga NJSBCZHK përdoren në mbështetje të procesit të promovimit të stafit akademik i cili ka avancuar referuar titujve shkencorë. https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të	UMSH përdor një sërë mekanizmash për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë si p.sh. vlerësimet e studentëve falë pyetësorëve, fokus-grupet apo vlerësimet e stafeve etj (<i>Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punes NJSBCZHK</i>). Një tjetër mekanizëm i përdorur për rritjen e cilësisë është edhe procesi i rishikimit të syllabuseve ku merret në konsideratë edhe mendimi i studentëve, procesi i monitorimit të programeve mësimore, etj. të cilat bëhen transparente për të zbatuar një proces sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës. (https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise).

provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Integrimi i cilësisë së mësimdhënies me politikat mbështetëse për studentët krijon mundësinë e pasjes së disa strukturave në dispozicion të këtij objekti siç janë për shembull Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, etj.			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	GVJ vlerëson instrumentat e përdorura për vlerësimin e realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit. Këto përfshijnë metodat e NJSBCZHK si sondazhe të opinioneve të studentëve aktualë të cilët japin vlerësimin për pedagogët dhe lëndët sipas formatit të miratuar në UMSH. Po ashtu fokus-grupet me studentë përfaqësues të çdo programi, që zhvillohen sipas një metodologjie të caktuar. Metodatat e drejtpërdrejta me intervista të stafit akademik e ndihmës akademik janë pasqyruar në Rregulloret e UMSH dhe NJSBCZHK. Njësia e ALUMNIT bën sondazhet dhe gjurmon studentët e diplomuar, evidenton problemet në përshtatjen me vendet e punës të njohurive të fituara në programin e studimit dhe përmirësimet e mundshme, si dhe bashkëpunimet me institucionet me të cilat UMSH ka marrëveshje institucionale. (Evidenca Nr.25. Formulari i Vlerësimit të Pedagogut dhe Lëndës nga Studenti; Evidenca Nr.31. Formular i Vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues; Evidenca Nr.34. Procedura e punës me fokus grupet) https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni https://www.umsh.edu.al/d/177/mblidhet-umshalumni-sot-ish-studentet-te-punesuar-ne-administrate-e-institucione-private			
Konkluzione	UMSH monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike përmes organeve përkatëse cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit dhe kapaciteteve profesionale të studentëve për të qenë sa më të përgatitur për nevojat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në kuadrin rregullator, institucioni i ka të parashikuara politikat dhe procedurat e brendshme të sigurimit të cilësisë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se këto politika garantojnë e zbatohen përmes një procesi të përfshirjes së strukturave të brendshme si NJSBCZHK, njësite kryesore dhe ato bazë, studentëve, ALUMNI, bashkëpunimit me institucionet me të cilat UMSH ka marrëveshje për praktikën e studentëve dhe ASCAL. Këto janë reflektuar në përmirësimin e programit të studimit i cili ka realizuar përmirësimin e kurrikulës duke e profilizuar atë në tre drejtime. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e organizimit të UMSH; Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK; Evidenca 48. Plan i punës së NJSBCZHK).</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për të gjitha hallkat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. NJSBCZHK për monitorimin e cilësisë ka përcaktuar formate për vlerësimin e pedagogut dhe lëndës nga studenti; fokus grupet e studentëve, takimet me Këshillin studentor si dhe kontaktet me të gjitha njësitë e tjera të UMSH. Detyrat dhe përgjegjësitë e secilit individ të përfshirë për sigurimin e cilësisë bëhen të qarta në Rregulloren e NJSBCZHK dhe udhëzimet për procese të caktuara. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e organizimit të UMSH; Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK; Evidenca 48. Plan i punës së NJSBCZHK).</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e	UMSH garanton ushtrimin me përgjegjësi të detyrave për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit përmes strukturave përgjegjëse si NJSBCZHK, në bashkëpunim me personelin akademik, ndihmës akademik të Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, duke kërkuar vlerësimet periodike të studentëve dhe bashkëpunëtorëve të

studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	jashtëm. Organet e sigurimit të cilësisë së bashku me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit janë përgjegjës për çështjet e cilësisë, duke monitoruar të gjitha proceset, aktivitetet dhe veprimtaritë si akademike edhe të shërbimeve, falë mekanizmave të përmendura më lart. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e organizimit të UMSH; Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK; Evidenca 48. Plani i punës së NJSBCZHK).</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në respekt të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale”, gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të UMSH për sigurimin e cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respekton integritetin akademik, etikën dhe lirinë akademike. Në proceset periodike të vlerësimit, aktivizimi dhe përfshirja e aktorëve të brendshëm shmang çdo lloj diskriminimi kundrejt personelit dhe studentëve. Edhe pyetësorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike ruajnë anonimin dhe konfidencialitetin e tyre. NJSBCZHK përbëhet nga 9 anëtarë me mandat 3 vjeçar. <i>(Evidenca Nr.1. Statuti UMSH; Evidenca Nr.2. Rregullore e organizimit të UMSH; Evidenca Nr.18. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK; Evidenca 48. Plani i punës së NJSBCZHK).</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në procesin e vlerësimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, UMSH ka përfshirë edhe përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorë të tjerë me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi, bazuar në Rregulloret ku përcaktohen kritere të tilla të funksionimit të këtij sistemi. Bashkëpunëtorët apo ekspertët e jashtëm, të cilët në rastin e DSHPMN janë edhe të diplomuarit e tij të punësuar në institucione ku ftojnë dhe supervizojnë praktikantët e studentëve, si dhe japin ekspertizat e tyre për tematika të lidhura me programin e studimit gjatë aktiviteteve ku ata janë ftuar në UMSH si konferenca, takime, promovime librash, etj. Këto i kanë shërbyer përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidenca Nr.10. Marrëveshjet e bashkëpunimit; Evidenca 18. Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK).</i>
Konkluzione	UMSH ka të përcaktuar qartë politikën dhe rregulloret për proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Njësitë



	si NJSBCZHK, personeli akademik e ndihmës akademike, studentët, alumni, bashkëpunëtorët e jashtëm apo të tjerë bashkëpunëtorë janë të përfshirë dhe informohen në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim përmes takimeve, raporteve, aktiviteteve të organizuara nga institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në bazën rregullative të institucionit dhe më specifikisht në Rregullore e organizimit dhe punes NJSBCZHK, dhe në planin e përvitshëm që hartohet duke u bazuar në konkluzionet e raporteve të cilësisë së hartuara, si edhe objektivat e strukturave akademike përkatëse. GVJ vlerëson se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit nga UMSH/ FDSHH/ DSHPMN janë transparente dhe bëhen publike. UMSH ka bërë publike raportet e përvitshme vjetore si dhe ka azhurnuar rregullisht informacione të paanshme dhe objektive, cilësore dhe sasiore të programeve të studimit, në lidhje me informimin publik të funksionimit dhe rezultatet e sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në institucion. https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UMSH publikon në faqen zyrtare të universitetit një raport përmbledhës i NJSBCZHK si dhe të gjitha vlerësimet e programeve të studimit për akreditimin institucional dhe vendos në dispozicion të publikut të gjitha vlerësimet nga ASCAL. Të gjitha raportet, vlerësimet dhe sygjerimet e kësaj njesie pasi përcillen në rektorat, administrohen nga ky i fundit në mënyrë që ti shërbejnë njësive kryesore dhe njësive bazë për përmirësimin e programeve dhe reflektimin për rritje dhe ruajtje të cilësisë për çështje të ndryshme. Në faqen online shpallet një raport përmbledhës i NJSBCZHK, raporti i detajuar me emra të veçantë qëndron në rektorat dhe u bëhet

Masa


	me dije gjithsecilit përgjatë matjes së performancës në fund të vitit akademik, duke respektuar në këtë mënyrë lirinë akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale. (RVB, fq. 68; https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise).			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare bazuar në rezultatet e vlerësimit, angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime në ndryshime të programit të studimit, avancime të karrierës së stafit akademik, rritje të bashkëpunimit me institucione të tjera. Ndryshimet e realizuara në kurrikulën e këtij programi studimi ishin si rezultat i gjetjeve nga akreditimi i mëparshëm i programit.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Harmonizimi i aktivitetit të strukturave të ndryshme të UMSH me NJSBCZHK siguron koherencë dhe gjithëpërfshirje në sigurimin e cilësisë. Rezultatet e kësaj pune përmbledhen në realizimin e një raporti vjetor ku përfshihen veprimtaritë që këto struktura kanë realizuar për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet e programeve mësimore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. (https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise)			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare organizon takime informuese me stafin akademik dhe studentët për rritjen e ndërgjegjësimin të personelit me trajnime mbi standardet e cilësisë. Departamenti informon studentët me kërkesat mbi cilësinë që nga fillimi i vitit akademik e në vazhdim ku si pedagogët për lendët respektive edhe stafet administrative qartësojnë elementë të ndryshë të programit të studimit. Aktiviteti i NJSBCZHK ka një rol të veçantë në këtë drejtim me tërheqjen e opinionëve të studentëve për sigurimin e cilësisë. (Evidenca Nr.14.3 CV e stafit të programit; Evidenca Nr.28. Programi i trajnimeve 2022-2023)			
Konkluzione	Prioritetet e vendosura, politikat, proceset e zbatuara, kriteret e përdorura dhe veprimtaritë e zhvilluara për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente për të bërë sa më efektive implementimin e tyre, duke synuar krijimin e një kulture institucionale për arritjen e cilësisë dhe përmirësimin e proceseve për monitorimin e saj. Një përmbledhje e raportit të realizuar nga NJSBCZHK publikohet në faqen online të UMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politika Sociale”, “Administratë Publike”, “Qeverisje Vendore” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit është riorganizuar për t’ju përshtatur më mirë Planit strategjik të zhvillimit, statutit dhe rregullores së UMSH, dhe është në harmoni me interesat kombëtare të vendit.
2. Institucioni ka të angazhuar në programin e studimit staf akademik me përvojë në fushat respektive dhe me karrierë të konsiderueshme akademike.
3. Institucioni ka një infrastrukturë institucionale të mirë-organizuar dhe mbështetje finaciare për mobilitetin e studentëve dhe zhvillimin akademik të pedagogëve.
4. Institucioni ka infrastrukturë moderne për zhvillimin e procesit mësimor.
5. Institucioni ka ndërtuar bashkëpunime të frytshme me institucionet publike e jopublike në vend si dhe me universitetet e huaja.
6. Institucioni ka shtëpi botuese dhe revista shkencore duke krijuar hapësira dhe mundësi për publikime të stafit akademik.
7. Institucioni ndjek politika sociale nëpërmjet mbështetjes me bursa studimi për kandidatës e aftë por që nuk kanë mundësi financiare.

Pika të dobta

1. Mospërputhje e fushës së programit të studimit (Shkenca Sociale) me njësinë kryesore, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane. Bazuar në kategorizimin e ISCED, programi dhe njësia kryesore janë në nivele të ndryshme. (Standardi I, Kriteri II).

Maso

84

2. Në lidhje me rekomandimet e pikës a, UMSH dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në vazhdimësi kanë bërë rishikimin në planet mësimore, por ende nuk kanë përfshirë lëndë me zgjedhje si pjese e aktiviteteve formuese të kurrikulës.
3. Literatura në Bibliotekën e UMSH ndonëse e pasur, sikurse edhe syllabuset, kanë kufizime në referencat me botimet më të reja (të 5 viteve të fundit).
4. Nuk rezulton që njësia bazë të realizojë në mënyrë periodike raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. (Standardi I.3; Kriteri 4)

Rekomandime

1. Referuar mospërputhjes së fushës së programit të studimit me njësinë kryesore, Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane, kërkohet reflektim nga institucioni. (Standardi I, Kriteri II)
2. Institucioni duhet të përshtasë planin mësimor të programit të studimit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi duke përfshirë lëndë me zgjedhje si pjesë e aktiviteteve formuese.
3. Përditësimi i vazhdueshëm i literaturës tek programet lëndore me botime të reja pasi një pjesë e mirë e literaturës detyruese dhe të rekomanduar është jo e 5 viteve të fundit. Pasurimi i bibliotekës me libra të dedikuara lëndëve të këtij program studimi do ishte një vlerë e shtuar në rritjen e cilësisë të programit. (Standardi II.3)
4. Njësia bazë të realizojë në mënyrë periodike raporte analitike nga përfitueshmëria e marrëveshjeve në kuadër të realizimit të këtij programi studimi. (Standardi V.4; Kriteri 5)
5. GJVJ sygjeron që në të ardhmen institucioni të planifikojë marrjen e një programi elektronik anti-plagjaturë.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in "Political and Administrative Sciences," with profiles in "Social Policy," "Public Administration," and "Local Governance," provided by the Higher Education Institution "University of Mediterranean Studies of Albania."

Strengths and affirmations

1. The study program has been reorganized to better align with the Strategic Development Plan, the statute, and the regulations of the University of Mediterranean Studies (UMSH), and is in harmony with the national interests of the country.

Maso



2. The institution has engaged academic staff with extensive experience in their respective fields and a distinguished academic career in the study program.
3. The institution has a well-organized institutional infrastructure and financial support for student mobility and the academic development of faculty members.
4. The institution has modern infrastructure for the development of the teaching process.
5. The institution has established fruitful collaborations with both public and private institutions in the country, as well as with foreign universities.
6. The institution has its own publishing house and scientific journals, providing opportunities and platforms for academic staff publications.
7. The institution follows social policies by offering scholarships to capable candidates who lack financial means.

Weaknesses

1. Mismatch between the field of study (Social Sciences) and the main unit, Faculty of Law and Humanities. Based on the ISCED categorization, the program and the main unit are at different levels. (Standard I, Criterion II).
2. With regard to the recommendations in point a, UMSH and the Department of Political Science and International Relations have consistently reviewed the curriculum, but have not yet incorporated elective courses as part of the curriculum's formative activities.
3. Although the literature in the UMSH Library is extensive, as well as the syllabi, there are limitations in terms of references to more recent publications (from the last 5 years).
4. There is no evidence that the department periodically generates analytical reports on the outcomes of cooperation agreements in relation to the implementation of the study program. (Standard I.3; Criterion 4)

Recommendation

1. With regard to the mismatch between the field of study and the Faculty of Law and Humanities, the institution is required to reflect on this matter. (Standard I, Criterion II)
2. The institution must adapt the curriculum of the study program in accordance with the applicable secondary legislation, including the incorporation of elective courses as part of the formative activities.
3. Continuous updating of the literature in the course programs with recent publications, as a significant portion of the required and recommended literature is outdated (not from the

Masa

[Signature]

last 5 years). Enriching the library with books dedicated to the subjects of this study program would add value to the improvement of the program's quality. (Standard II.3)

4. The department must periodically generate analytical reports on the effectiveness of cooperation agreements in relation to the implementation of this study program. (Standard V.4; Criterion 5)
5. The GVJ recommends that, in the future, the institution plans to acquire an anti-plagiarism software program.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X

Masa



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Mase

H